HENRI XHEJMS
Deizi Miler

I

Qyteti i vogël zviceran,Vevey, ka një hotel jashtëzakonisht të rehatshëm. Në të vërtetë, ka shumë hotele, pasi turizmi është biznesi kryesor i këtij qyteti, i cili ia vlen të vizitohet e që, siç do ta kujtojnë udhëtarët, vendoset në brigjet e një liqeni aq blu. Në brigjet e liqenit shtrihet një radhë e plotë hotelesh, të çdo kategorie, që nga të quajturit "Grand Hotel" të modës më të fundit, me fasadë të bardhë, njëqind ballkone dhe një duzinë flamujsh që valëviten në çati, deri te pensioni i vogël zviceran i kohëve më të hershme, me emrin shkruar prej germash gotike mbi një mur rozë apo të verdhë dhe me një tendë pa shije në cep të kopshtit. Sidoqoftë, njëri prej hoteleve është i famshëm, klasik, sepse shquhet nga fqinjët e tij snobë prej një pamje luksi dhe moshe. Gjatë korrikut, ky vend mbushet me udhëtarë amerikanë, saqë mund të thuhet se në këtë periudhë Vevey merr karakteristika të një plazhi amerikan. Ka shumë pamje dhe tone që evokojnë një vizion, një jehonë, të Njuportit dhe Saratogës. Vejevinë vajza elegante, duke fëshfëritur dantellat e fustaneve të shtrenjtë, ushton muzika e vallëzimit deri në orët e mëngjesit, një jehonë zërash të fortë gjatë gjithë kohës. Përshtypje të tilla merren në hotelin e mrekullueshëm "Tri stemat", por tani i has edhe te hotelet "Shtëpia e oqeanit" dhe "Holli i kongresit". Duhet shtuar se te "Tri stemat" ka disa veçori të tjera, që ndryshojnë shumë nga të sipërpërmendurat: aty ka kamerierë të përpiktë, që duken si sekretarë legatash, ka princesha ruse në kopsht, djem të vegjël polakë që vinë rrotull, duke mbajtur përdore guvernantet, si dhe një pamje të majës me borë të *Dent dy Midi* e kullat e Kështjellës së Shilonit.

Është e vështirë ta di sot, nëse vepronin më fort ngjashmëritë apo dallimet në mendjen e një djaloshi amerikan, i dy apo tre vjet më

parë, rrinte në kopshtin e "Tri stemave", duke parë dembelisht përreth gjërat e këndshme që përmenda. Ishte mëngjes i rnrekullueshëm vere dhe në çfarëdo mënyre t'i ketë parë ato, duhet t'i jenë dukur tepër joshëse. Kishte ardhur një ditë më parë me një avullore të vogël nga Gjeneva -vendqëndrim i gjatë për të për të parë tezen që rrinte në hotel. Tezja kishte dhimbje koke, ajo kishte gjithmonë dhimbje koke, dhe rrinte mbyllur në dhomën e saj, duke thithur kamfur, kështu që ai ishte i lirë për të dalë. Ishte rreth njëzet e shtatë vjeç dhe, kur flisnin për të, zakonisht shokët thoshin se në Gjenevë "studionte". Kur flisnin armiqtë për të, thoshin (kot them armiqtë, ai nuk kishte ishte një djalë thellësisht miqësor dhe duhej, pa përjashtim, prej të gjithëve. Ajo çfarë do të doja të thosha, është se disa pohonin që, arsyeja e qëndrimit në Gjenevë, qe përkushtimi i thellë ndaj një zonje, një zonjë e huaj, më e madhe në moshë se ai. Shumë pak amerikanë - në fakt, unë mendoj se nuk gjendej ndonjë i tillë - e njihnin këtë zonjë, për të cilën fliteshin gjëra të çuditshme. Sidoqoftë, Uinterborni kishte lidhje të hershme me metropolin e vockël të kalvinizmit, pasi atje kishte ndjekur klasat e ulëta dhe kolegjin, rrethana që e ndihmuan për të krijuar shumë miqësi të kësaj moshe. E kishte ruajtur shumicën e këtyre miqësive, duke gjetur në to burim të madh kënaqësie.

Pasi trokiti në derën e tezes dhe mësoi se ajo qe e pamundur një herë për njëherë, bëri një shëtitje në qytet, duke u kthyer vetëm për ngrënien e mëngjesit. E kishte mbaruar ushqimin dhe po pinte një kafe, të shërbyer në një tavolinë të vogël, prej njërit nga kamerierët që dukeshin si atashe ambasade. Pasi mbaroi kafenë, ndezi një cigare. Shumë shpejt u shfaq një djalë i vogël, që ecte nëpër kalimin e ngushtë, një çamarrok nëntë apo dhjetë vjeç. Fëmija, trupvogël për moshën e vet, kishte një pamje të pjekur të fytyrës, një lëkurë shumë të bardhë dhe tipare të theksuara. Mbante veshur kilota me çorapë të kuq, të cilat ia vinin në dukje kërcinjtë e hollë, si dhe një kravatë të kuqe gjithë

shkëlqim. Mbante në dorë një shkop të gjatë alpinistësh, me majën e të cilit trazonte çdo gjë që i dilte përpara - lehet e luleve, stolat dhe bishtat e zgjatur të fustaneve të grave. Përballë Uinterbornit ai ndaloi, duke e parë atë me sytë e vegjël, të ndritshëm dhe depërtues.

- A do të më jepni një top sheqeri? - pyeti, me zërin e mprehtë dhe të prerë, një zë i papjekur, megjithatë, disi jo prej fëmije.

Uinterborni hodhi një vështrim të shpejtë te tryeza e vogël, mbi të cilën i qe shërbyer kafeja dhe pa disa copa të mbetura sheqeri.

- Mund ta merrni një, - i tha, - por nuk mendoj se sheqeri është gjë e mirë për djemtë e vegjël.

Djali bëri përpara dhe zgjodhi tri nga copat më të lakmueshrne, dy prej të cilave i rrasi në xhepin e kilotave, ndërsa për të tretën gjeti menjëherë një vend tjetër. Mbështeti shkopin si heshtë në stolin e Uinterbornit dhe u përpoq të thyente me dhëmbë copën e sheqerit.

- Ta marrë dreqi! Është e fo-r-rtë! - thirri, duke e shqiptuar fjalën e fundit në mënyrë të çuditshme.

Uinterborni e pa menjëherë se i takonte ta quante bashkatdhetar, të voglin.

- Kujdes, se do të thyesh dhëmbët! - i foli me ton atëror.

- Nuk kam çfarë të thyej. Më kanë rënë. Vetëm shtatë më kanë mbetur. Sapo m'i numëroi nëna mbrëmë, menjëherë më ra tjetri. Më tha se do të më godiste me pëllëmbë, nëse do të më binte ndonjë tjetër. Nuk kam ç'bëj. Fajin e ka kjo Evropa plakë. Prej klimës së saj më bien dhërnbët. Në Amerikë i kisha shëndoshë e mirë. Hotelet e kanë fajin.

Uinterborni po dëfrehej.

- Nëse ti ha tri copa sheqeri, sigurisht, që nëna do të të rrahë, - i tha.

- Atëherë, le të më japë karamele, - u përgjigj bashkëbiseduesi i vogël. - Nuk gjej karamele amerikane këtu. S'ka këtu si karamelet amerikane.

- Edhe djemtë amerikanë janë më të mirët? - pyeti Uinterborni.

- Nuk e di. Unë jam vetë djalë amerikan, tha fëmija.

- E shoh, je një nga më të mirët, - qeshi Uinterborni.

- Amerikan jeni ju? - e ndoqi ky fëmijë jetëgjallë.

Kur dëgjoi përgjigjen pohuese të Uinterbornit, ai shpalli:

- Amerikanët janë më të mirët.

Pasi falënderoi bashkëbiseduesin për komplimentin, fëmija, që tashti i kishte hipur si kalë shkopit të tij dhe shihte rreth e rrotull, iu sul copës së dytë të sheqerit. Uinterborni pyeste veten nëse kishte qenë dikur si ky fëmijë, pasi e kishin sjellë në Evropë pothuajse në të njëjtën moshë.

- Ja ku po vjen motra ime, - thirri fëmija, pas një copë here. - Është amerikane.

Uinterborni hodhi vështrimin nëpër kalimin e ngushtë dhe pa tek po vinte një zonjushë e mrekullueshme.

- Vajzat amerikane janë më të mirat, - i tha gëzueshëm bashkëbiseduesit të vogël.

- Motra ime s'është nga më të mirat, - ia ktheu i vogli. - Ajo më çirret vazhdimisht.

- Mendoj se nuk duhet të jetë faji i saj, po i yti, - tha Uinterborni.

Ndërkaq, zonjusha qe afruar. Mbante veshur një fustan të shtrenjtë, plot lidhëse, dantella e fjongo shiritash në ngjyrë të çelët. Ishte pa kapelë, por i peshonte në dorë një çadër kundër diellit, qëndisur në anë dhe rrezatonte një bukuri të admirueshme, që të prekte thellë. "Sa të bukura janë", mendoi Uinterborni, duke u drejtuar në ndenjëse, sikur përgatitej të ngrihej.

Vajza qëndroi përballë stolit të tij, pranë parmakut të kopshtit, me pamje nga liqeni. Tashti, vogëlushi e kishte shndërruar shkopin në një nga ato që përdorin atletët e kërcimit së larti, me ndihmën e të cilit po hidhej në çakëll, duke shqelmuar jo pak.

- Randolf, - i thirri vajza. - Çfarë bën ashtu?

- Po ngjitem në alpe, - ia ktheu fëmija. - Kjo është rnënyra për t'u ngjitur atje.

Dhe ia dha një kërcimi tjetër, duke i çuar guraleca deri te veshët e Uinterbornit.

- Kjo është mënyra për të zbritur, - tha Uinterborni.

- Është amerikan, - thirri Randolfi, me zërin e tij të mprehtë. Vajza nuk u kushtoi vëmendje këtyre fialëve, por pa drejt e te i vëllai.

- Po mendoja që duhet të jesh djalë i mbarë, - vetëm sa i hoqi vërejtje ajo.

Uinterbornit kjo iu duk një mënyrë prezantimi. U ngrit dhe iu afrua vajzës ngadalë, duke flakur cigaren tej.

- Me djaioshin jemi prezantuar, - tha me mirësjellje të madhe.

Ai e dinte mirë se, në Gjenevë, një djalë nuk mund t'i flasë një femre te pamartuar, përveçse në disa rrethana të veçanta, por këtu, në Vevev, a mund të kishte rrethana më të mira se këto një vajzë amerikane vjen e ju qëndron përballë në një kopsht. Megjithatë, kjo vajzë e bukur amerikane që po vëzhgonte Uinterborni, vetëm se i hodhi një vështrim të shpejtë, sepse ktheu kokën dhe pa liqenin e malet përballë. Ai pyeti veten nëse kishte ecur shumë përpara, megjithatë donte të shtyhej më tej e jo të tërhiqej. Po ende nuk kishte arritur të fliste, kur vajza u kthye nga i vëllai dhe i tha:

- A më tregon se ku e ke marrë atë shkop.

- E bleva, - iu përgjigj Randolfi.

- Nuk ke ndërmend ta marrësh me vete në Itali!

- Në të vërtetë, po, - ia ktheu djaloshi.

Vajza i hodhi një vështrim kalirrithi fustanit dhe rregulloi një apo dy rripa. Pastaj e ktheu shikimin aty ku e kishte më parë.

- Mendoj se duhet ta lësh diku, - tha, pas pak.

- Do të shkoni në Itali? - pyeti Uinterborni, po me mirësjellje.

Vajza i hodhi të njëjtin shikim të shkurtër.

- Po, zotëri, iu përgjigj.

Dhe nuk e hapi gojën më.

- Do... do t'i bini nga Simploni? - vazhdoi Uinterborni, pak i turpshëm.

- Nuk e di, ia ktheu ajo. - Me sa di, është një mal Randolf, cilin mal na duhet të kalojmë?

- Për të shkuar ku? - pyeti djaloshi.

- Në Itali, - sqaroi Uinterborni.

- Nuk e di, - tha Randolfi. Unë nuk dua të shkoj në Itali. Unë dua të shkoj në Amerikë.

- Oh, Italia është vend i bukur! - ia ktheu Uinterborni.

- A ka karamele atje? - ngulmoi fort Randolfi.

- Nuk besoj, tha e motra. - Mendoj, si edhe nëna, se ke ngrënë shumë karamele.

- Ka njëqind javë që nuk kam ngrënë karamele, thirri vogëlushi, duke ardhur rrotull.

Vajza u bëri një kontroll dantellave, duke rregulluar rripat, dhe Uinterborni mori rrezikun në sy, për t'u shprehur për bukurinë e panoramës. Filloi ta hiqte sikletin, pasi e kuptoi se as ajo nuk tregonte ndonjë shqetësim. Në ngjyrën e bukur të fytyrës së saj joshëse nuk kishte lëvizur asgjë, sepse nuk dukej as e ofenduar, as e bezdisur. Nëse ajo shikonte në drejtim tjetër, kur i fliste ai, nëse nuk dukej se tregonte shumë vëmendje, ky qe një zakon, një mënyrë e saj për të dëgjuar. Megjithatë, pasi ai i foli për disa prej objekteve më interesante të panoramës, të cilat ajo s'i njihte fort, pak nga pak, vajza filloi t'i dhuronte gjithnjë e më shumë nga vështrimi i saj, derisa ky vështrim u bë i drejtpërdrejtë dhe krejt i çlirët. Ky nuk qe ai vështrim që mund të quhet i paturpshëm, sepse sytë e vajzës qenë shumë të sinqertë dhe të pafajshëm. Ishin sy mrekullisht të bukur dhe, në të vërtetë, duke fiEuar

nga ngjyra e fytyrës, hunda, veshët dhe dhëmbët, Uinterborni nuk kishte parë prej kohësh tipare më të bukura se ato të bashkatdhetares së vet. Ai kishte neps të madh për bukurinë femërore - qe shumë i dhënë pas vëzhgimit dhe analizës së saj - e, me këtë rast, duke pasur përpara fytyrën e vajzës së re, i bëri disa vrojtime. Nuk ishte e pashijshme, por jo edhe aq shumë shprehëse, megjithëse i dallohej qartë delikatesa dhe Uinterborni e akuzoi me mend, por zemërbutësisht, për mungesë finese. Ai e mendoi të mundshme që motra e Randolfit qe një koketë: kishte një krenari të sajën, por në pamjen gjithë dritë, të ëmbël dhe pak sipërfaqësore, nuk kishte qesëndi apo ironi. Më pas u bë e qartë se ajo qe shumë e prirur për bisedë. Tregoi se po shkonin në Romë për stinën e dimrit - ajo, nëna dhe Randolfi. Deshi të dinte nëse qe "amerikan i vërtet", sepse nuk do ta merrte kurrë për të tillë, pasi më shumë dukej si gjerman. Kjo u tha pas një ngurrimi të vogël, pikërisht kur foli ai. Duke qeshur, Uinterborni i tha se kishte parë gjermanë që flisnin si amerikanë, por, me sa i kujtohej, nuk kishte takuar ndonjë amerikan që të fliste si një gjerman. Pastaj, e pyeti nëse do të ishte e rehatshme për të ulja në stolin nga qe ngritur ai. Ajo u përg-igj se i pëlqente të rrinte në këmbë, duke lëvizur, por megjithatë, pas pak, u ul. Tregoi se qe nga shteti i Nju Jorkut.

- Nëse e dini se ku bie.

Ai mësoi më shumë për të nga vëllai i vogël, të cilin e mbajti disa minuta në një cep.

- Tregomë si të quajnë, djalosh, - i tha.

- Randolf C. Miler, - ia ktheu djaloshi, me ton serioz. - Do të të tregoj edhe emrin e saj, shtoi, duke drejtuar shkopin nga e motra.

- Prit që t'jua kërkojnë më parë, tha e motra, krejt e qetë.

- Do të doja shumë që të di emrin tuaj, - tha Uinterborni.

- E ka emrin Deizi Miler, - thirri fëmija. - Por ky nuk është emri i saj i vërtetë, nuk është emri që mban në letra.

- Sa keq që nuk ke asnjë dokument timin, - tha zonjusha Miler.

- Emri i saj i vërtetë është An P. Miler, vazhdoi më tej i vogli.

- Pyete për emrin e tij, - i tha e motra, duke treguar nga Uinterborni.

Por Randolfi qe plotësisht indiferent në këtë pikë dhe vazhdoi të jepte informacione mbi familjen.

- Emri i babait është Ezra B. Miler, bëri të ditur. - Nuk është në Evropë. Ai është në një vend më të mirë se Evropa.

Për një çast, Uinterborni mendoi se kjo qe mënyra që i patën mësuar fëmijës, për të thënë se i ati ishte në parajsë. Por Randolfi shtoi menjëherë:

- Babai ndodhet në Skinkteidi. Ka një biznes të madh. Natyrisht, është i pasur.

- Mjaft! e ndërpreu zonjusha Miler, duke ulur çadrën dhe duke parë rrethin e saj të qëndisur.

Tashti Uinterborni e la të lirë fëmijën, i cili u largua, duke tërhequr shkopin nëpër kalimin e ngushtë.

- Nuk i pëlqen Evropa, - tha vajza. - Kërkon të kthehet.

- Në Skinkteidi, doni të thoni?

- Po, ai kërkon të shkojë drejt e në shtëpi. Nuk ka zënë asnjë shok në këto anë. Ka një fëmijë këtu, por ai shoqërohet gjithë kohës nga një mësues që nuk i lë mundësi për të luajtur.

- Vëllai juaj nuk ka ndonjë mësues? - deshi të dijë Uinterborni.

- Nëna mendon ta marrë një, i cili të vijë kudo me ne. Një zonjë na foli për një mësues shumë të mirë, një zonjë amerikane, ndoshta mund ta njihni, zonja Sanders. Mendoj se është nga Bostoni. Ajo i foli nënës për mësuesin dhe ne po mendojmë që ai të vijë kudo me ne. Por Randolfi thotë se nuk do që një mësues të vijë kudo me ne. Thotë se nuk do t'i jepet mësimit, kur të jetë në udhëtim. Dhe ne jemi në udhëtim gjysmën e kohës. Takuam në tren një zonjë angleze - që quhet zonja

Featherstone, më duket - ndoshta mund ta njihni. Ajo deshi të dijë se pse nuk i jepja unë mësime Randolfit t'i jepja "udhëzirne", siç i quajti ajo. Kam frikë se ai do të më jepte mua më shumë të tilla, sesa do t'i jepja unë atij. Është shumë i mprehtë.

- Po, aprovoi Uinterborni, - duket shumë i mprehtë.

- Nëna kërkon të marrë mësues, sapo të shkojmë në Itali. A mund të gjenden mësues të mirë në Itali?

- Shumë të mirë, do të thosha, ia ktheu Uinterborni.

- Përndryshe, ajo kërkon të gjejë një shkollë për të. Duhet të mësojë më fort. Është vetëm nëntë vjeç. Duhet të shkoj kolegj.

Zonjusha Miler foli për punët e familjes së vet, por edhe për gjëra të tjera. Rrinte aty me duart jashtëzakonisht të bukura (plot unaza të shkëlqyera e të stolisura) përthyer në prehër dhe me sytë e mrekullueshërn, që herë ia ngulte Uinterbornit, herë i shëtiste mbi kopsht, mbi njerëzit që kalonin aty e herë mbi pamjen e rrallë. I fliste Uinterbornit sikur e njihte prej kohësh dhe ai po tërhiqej shumë prej saj. Kishte kohë pa dëgjuar që një vajzë t'i fliste kaq shumë. Mund të thuhet që ajo zonjushë e panjohur, ulur në një stol pranë uj, nuk mbajti asgjë për vete. E ulur në një pozicion shumë tërheqës dhe të qetë, ajo ishte shumë e paqtë, por buzët dhe sytë i lëviznin pa pushim. Toni i zërit të butë, të hollë e të këndshëm, ishte thellësisht miqësor. Tregoi të gjitha lëvizjet dhe planet e saj, të nënës dhe të vëllait, nëpër Evropë dhe numëroi, veçanërisht, hotelet e shumta ku kishin qëndruar.

- Anglezja që takuam në tren, tha, - zonja Featherstone, deshi të dijë nëse jetonim nëpër hotele edhe në Amerikë. Ia ktheva se nuk kisha parë kaq shumë hotele, derisa erdhëm në Evropë. Nuk kam parë kurrë kaq shumë të tillë, thuajse nuk ka gjë tjetër, veçse hotele.

Në këtë vërejtje të zonjushës Miler nuk kishte ndonjë theks ankues, pasi dukej e kënagur me çdo gjë. Ajo tha se hotelet janë shumë të mira, nëse mësohesh me to dhe se Evropa është shumë e këndshme.

Nuk ishte zhgënjyer asnjëherë. Ndoshta ngaqë kishte dëgjuar për të që përpara. Shumë shoqe të saj kishin qenë këtu, madje disa herë. Pastaj, kishte shumë rroba e gjëra të tjera nga Parisi. Sa herë vishte ndonjë fustan parisien, ndihej si në Evropë.

- Është si puna e asaj kapelës që na i realizon dëshirat, - tha Uinterborni.

- Po, - tha zonjusha Miler, pa ndier nevojën që ta shihte më gjatë atë analogji. - Kam dashur gjithmonë të vij në Evropë. Jo për rroba, sigurisht. Jam e sigurt se i nisin të gjitha rrobat më të bukura në Amerikë - shumicën e gjërave të shëmtuara mund ta shihni këtu. E vetmja gjë që nuk më pëlcien në këtë, vend është shoqëria. Nuk gjej ndonjë shoqëri apo, nëse është diku, nuk di unë ta gjej. A mund të ma thoni ju? Mendoj se duhet të jetë diku, por unë s'i bie në të. Jam shumë e dhënë pas shoqërisë, pasi kam qenë gjithmonë e tinë. Nuk dua të them vetëm në Skinkteidi, por edhe në Nju Jork. Shkoja aty çdo dimër. Kisha shumë shoqëri atje. Herën e fundit kisha shtatëmbëdhjetë ftesa për drekë, tri prej të cilave qenë nga zotërinj. Kam më shumë miq në Nju Jork, se sa në Skinkteidi - më shumë miq, si edhe mikesha, gjithashtu.

Prapë heshti për një çast, duke e parë Uinterbornin me tërë bukurinë e shikimit dhe buzëqeshjen gjithë dritë e pakëz të njëtrajtshme.

- Gjithmonë jam tërhequr më shumë nga shoqëria e zotërinjve, - shtoi.

I shkreti Uinterborn qe zbavitur, hutuar, por edhe magjepsur. Nuk kishte pasur rast që një vajzë t'i hapej në këtë mënyrë, asnjëherë, përveç rasteve, ndoshta, kur diçka e tillë duket si shprehje e hapur e disa lirive të sjelljes. Po a mund ta akuzonte zonjushën Deizi. Miler për *inconduite*[1] të çastit apo të mundshme, siç thoshin në Gjenevë? Ndjeu se kishte jetuar aq shumë në Gjenevë, sa kishte humbur tingëllimin

[1] *Inconduite – Sjelle e papërshtatshme (frëngj.)*

amerikan. Në të vërtetë, asnjëherë, qysh se qe rritur sa për të marrë vesh nga bota, nuk kishte takuar një vajzë amerikane kaq mbresëlënëse sa kjo. Padyshim, qe kaq magjepsëse dhe kaq tmerrësisht e hapur! A ishte thjesht një vajzë e bukur nga shteti i Nju Jorkut dhe a ishin të gjitha kështu, të tërhequra më shumë nga shoqëria e burrave? Apo ishte një vajzë me synime të veçanta, e pacipë dhe pa skrupuj? Uinterborni e kishte humbur dhe nuk i vinte dot në ndihrnë arsyeja. Zonjusha Deizi Miler dukej thellësisht e pafajshme. Disa i thoshin se vajzat amerikane janë jashtëzakonisht të çiltra, ndërsa disa të tjerë thoshin të kundërtën: pra, që nuk janë të tilla. Po prirej të mendonte se Deizi Miler ishte një bishtpërdredhur, një bishtpërdredhur e bukur amerikane. Mirëpo, ai nuk kishte pasur lidhje kurrë me femra të këtij lloji. Kishte njohur këtu në Evropë dy apo tri femra, pak më të mëdha në moshë se Deizi Miler, që mbanin burra sa për të thënë, të cilat ishin koketa të mëdha, gra të rrezikshme, të tmerrshme, sepse marrëdhëniet me to merrnin përpjesëtime shumë serioze. Kjo vajzë nuk qe koketë në atë kuptim, sepse qe e papërvojë: ajo qe vetëm një bukuroshe amerikane, që e tërhiqte flirti. Uinterborni u ndie mirë që arriti ta përcaktonte si duhej zonjushën Deizi Miler. U mbështet mirë në ndenjëse dhe, pasi mendoi se ajo kishte hundën më tunduese që kishte parë ndonjëherë, filloi të pyesë veten për kushtet dhe kufijtë e duhur me një bukuroshe amerikane të gatshme për të flirtuar. Pas pak, iu duk se do të fillonte të mësohej.

- A keni qenë te ajo kështjella e vjetër? - pyeti vajza, duke treguar me çadrën e saj muret vezulluese të Kështjellës së Shilonit.

- Po. Kohë më parë, kam qenë më se një herë, - ia ktheu Uinterborni. - Mendoj se edhe ju, gjithashtu, e keni vizituar atë, apo jo?

- Jo. Ne nuk kemi qenë ndonjëherë atje. Por mua më pëlqen shumë të shkoj. Sigurisht që do të shkoj. Nuk iki prej k-tu, pa e parë atë kështjellë të vjetër.

- Është diçka shumë e bukur, - tha Uinterborni. - Dhe shkohet lehtë. Mund të shkoni me karrocë, ose me avullore.

- Mund të shkohet me karrocë - tha zonjusha Miler.

- Po. Mund të shkohet me karrocë, - e mbështeti Uinterborni.

- Shoqëruesi ynë thotë se karroca e postës të çon drejt e në kullë, vazhdoi vajza. - Donim të shkonim para një jave, por nëna hoqi dorë. Ajo ka dhimbje të tmerrshme stomaku. Tha se nuk mund të shkonte. As Randolfi nuk do të shkojë: thotë se nuk e ha meraku për kështjella të vjetra.

- Vëllait tënd nuk i pëlqejnë monumentet e vjetra? - buzëqeshi Uinterborni.

- Thotë se nuk kanë asnjë interes për të. Ai është vetëm nëntë vjeç. I pëlqen të rrijë në hotel. Nëna ka frikë ta lërë vetëm, kurse shoqëruesi ynë nuk qëndron me të, prandaj nuk kemi lëvizur dhe aq. Por do të ndihesha shumë keq nëse nuk do ta vizitoja atë kështjellë.

Ajo bëri përsëri me shenjë nga Kështjella e Shilonit.

- Unë mendoj se është gjë që rregullohet, - tha Uinterborni. - Nuk mund të gjendet dikush që qëndrojë një pasdite me Randolfin?

Zonjusha Miler e pa një hop dhe tha me shumë qetësi:

- Sikur ta bënit ju këtë gjë. Uinterborni ngurroi një çast.

- Më fort do të doja të vija në kështjellë me ju.

- Me mua? - pyeti vajza me të njëjtën qetësi.

Ajo nuk u ngrit, e skuqur, siç do të bënte një vajzë Gjenevë, megjithatë, Uinterborni qe i ndërgjegjshëm se nuk kishte vepruar si duhej pasi mund ta kishte prekur.

- Me gjithë nënën tuaj, - shtoi gjithë mirësjellje.

Dukej se kishin shkuar huq edhe guximi, edhe respekti.

- Them se nëna nuk ka ndërmend të shkojë, - ia ktheu ajo. - Asaj nuk i pëlqen të lëvizë me karrocë pasdrekeve. Po ju a e patët seriozisht, kur thatë se do të shkonit te kështjella?

- Më se seriozisht, - ia ktheu Uinterborni.

- Atëherë, mund të rregullohet. Nëse nëna do të qëndrojë me Randolfin, unë mendoj se do të rrijë edhe Eugjenio.

- Eugjenio? - ia priti ai.

- Eugjenio është shoqëruesi ynë. Atij nuk i pëlqen të rrijë me Randolfin, sepse është njeriu rnë qibar që kam parë ndonjëherë. Veçse është një shoqërues i shkëlqyeshëm. Them se do të pranojë të qëndrojë në shtëpi me Randolfin, nëse këtë gjë e bën edhe nëna, kështu që ne mund të shkojmë në kështjellë.

Uinterborni u përqendrua për një çast dhe mendoi se "ne" përfshinte atë dhe vajzën vetë. Kjo iu duk tepër e bukur për të qenë e vërtetë dhe gati sa nuk ia puthi dorën vajzës. Do ta kishte bërë këtë veprim, duke e çuar dëm të gjithë planin, por në atë çast u shfaq një person - sipas të gjitha gjasave, Eugjenio.

Një burrë i gjatë, i pashëm, me baseta madhështore, xhaketë kadife dhe një qostek të shkëlqyer, iu afrua zonjushës Miler, duke i hedhur një vështrim të vëmendshëm shoqëruesit të saj.

- Oh, Eugjenio! - thirri vajza me theks shumë miqësor.

Eugjenio, pasi e pa Uinterbornin nga koka te këmbët, bëri një përkulje respekti para vajzës.

- Kam nderin t'ju them, mademoiselle, që dreka është gati!

Zonjusha Miler u ngrit ngadalë.

- Dëgjo, Eugjenio, - i tha. - Do të shkoj patjetër te ajo kështjella e vjetër.

- Te kështjella e vjetër, mademoiselle? - pyeti shoqëruesi. Dhe shtoi me një ton që Uinterbornit iu duk i pacipë. - Zonjusha është bërë gati, me të gjitha?

Toni ironik i Eugjenios u kap edhe nga vajza vetë. Ajo u kthye nga Uintenborni, tashmë e skuqur lehtë.

- Do t'i rrini fjalës që thatë? - e pyeti.

- Nuk do të gjej rehat, deri sa të shkojmë, - tha ai me ngulmim.

- Dhe jeni te ky hotel? - vazhdoi ajo. - Dhe jeni vërtet amerikan?

Ndërkohë, shoqëruesi e shikonte Uinterbornin në mënyrë fyese. Për djaloshin ishte fyese mënyra se si e shikonte shoqëruesi vajzën: ai burrë po e mendonte vajzën shumë të lehtë.

- Do të kem nderin t'ju njoh me një njeri që do t'ju rrëfejë gjithçka për mua, - buzëqeshi djaloshi, duke pasur parasysh tezen.

- Kështu, pra, do të shkojmë te kështjella, - thirri zonjusha Miler.

I dha atij një buzëqeshje dhe u kthye pas. Ngriti çadrën dhe u nis te hoteli me Eugjenion në krah. Uinterborni, i cili e shikonte tek largohej, duke tërhequr fustanin e gjatë nëpër zhavorr, tha me vete se ajo kishte një *tournure*[2] princeshe.

II

Uinterborni mori përsipër më shumë se sa mund të bënte, kur i premtoi Deizi Milerit që do ta prezantonte te tezja e tij, zonja Kostello. Posa zonjës Kostello i kaluan pak dhimbjet e kokës, ai shkoi në apartamentin e saj dhe, pas bisedave në lidhje me shëndetin, e pyeti nëse kishte parë në hotel një familje amerikane - një nënë, një vajzë dhe një djalë të vogël.

- Dhe një shoqërues, - shtoi zonja Kostello. - Oh, po, i kam parë. I kam parë, i kam dëgjuar dhe kam ndenjur larg tyre.

[2] *Tournure – Mënyrë, sjellje, stil (frëngj.)*

Zonja Kostello ishte një vejushë e pasur, me një pozitë të veçantë në shoqërinë e zgjedhur, që aludonte se, nëse nuk do ta kishte atë dhimbje të tmerrshme koke, do të kishte lënë përshtypje më të thella në kohën e saj. Ajo kishte një fytyrë të zgjatur e të zbehtë, një hundë të ngritur dhe flokë të shumtë e mbresëlënës, të cilët i mbante të fryrë lart dhe gjithë bukle.

Kishte dy djem të martuar, ndërsa një tjetër ndodhej në Evropë. Ai më i vogli zbavitej në Hamburg dhe, megjithëse udhëtonte, rrallë kujtohej të vizitonte qytetin që zgjidhte e ëma për të qëndruar. Prandaj, nipi, i cili kishte ardhur për ta parë këtu në Vevey, ishte më i kujdesshëm se ata që qenë, siç thoshte vetë, gjaku i saj. Në Gjenevë, ai ishte ushqyer me idenë se dikush duhej të tregohej i kujdesshëm me tezen. Zonja Kostello nuk e kishte parë atë prej vitesh, prandaj, shumë e kënaqur nga kjo vizitë, e tregonte gëzimin duke e futur në shumë sekrete të pushtetit shoqëror, të cilin, siç jepte të kuptohej, e kishte ushtruar në kryeqytetin amerikan. E pranonte se qe shume përzgjedhëse me njerëzit, mirëpo, nëse ai ndodhej në Nju Jork do t'i duhej të bënte të njëjtën gjë. Paraqitja në detaje që i bëri ajo ndërtimit hierarkik të shoqërisë amerikane, të cilin e tregoi në pamje nga më të ndryshmet, pothuajse u fut thellë në imagjinatën e Uinterbornit.

Nga toni i saj, ai e mori vesh menjëherë që vendi zonjushës Deizi Miler në shkallën e shoqërisë, qe i ulët.

- Me sa shoh, nuk i pëlqyekeni ato, - tha ai.

- Janë shumë të rëndomta, - u shpreh hapur zonja Kostello. - Janë nga ai lloji i amerikaneve, që njeriu bën detyrën kur nuk i qas.

- Ah, ju nuk i pranoni fare ato? - pyeti djaloshi.

- Nuk mundem, Frederiku im i dashur, do pranoja, nëse do të mundja, por ja që nuk mundem.

- Vajza është shumë e bukur, - tha Uinterborni, pas një grime.

- Sigurisht që është e bukur. Por është shumë e rëndomtë.

- Sigurisht, e kuptoj se çfarë doni të thoni, - shtoi Uinterborni, pas një heshtjeje tjetër.

- Ka atë pamje tunduese, siç e ka secila prej tyre, - rifilloi tezja. - Nuk e kuptoj ku e marrin. Edhe veshjen e ka të përsosur, sepse e admiroj veshjen e saj. Nuk e di se ku a marrin atë shije.

- Oh, teze e dashur, në fund të fundit, ajo nuk është një indiane e paqytetëruar!

- Zonjusha, - tha teze Kostello, - ka miqësi më tepër se duhet mc shoqëruesin e së ëmës.

- Më tepër se duhet? - pyeti djaloshi.

- Oh, as e ëma s'është më e mirë! Ato e trajtojnë shoqëruesin me familjaritet të tepërt, si një zotëri. Me sa duket, për vajzën ai është një kont. Mbrëmjeve, ai qëndron me to në kopsht. Kam përshtypjes se edhe pi duhan në praninë e tyre.

Uinterborni i dëgjoi me interes ato gjëra të thëna hapur, sepse e ndihmonin që të krijonte një mendim për zonjushën Deizi. Dukej që ishte pak e pashtruar.

- Epo, ndërhyri ai, - unë nuk jam një shoqërues, megjithatë ajo është shumë tunduese për mua.

- Duhet të ma thoshe që në fillim, - tha zonja Kostello gjithë dinjitet, - që ti e paske njohur.

- Thjesht, u takuam në kopsht dhe biseduam pak.

- *Tout bonnement*![3] Dhe, ju lutem, çfarë biseduat?

- I thashë se merrja guximin për ta prezantuar te tezja ime e mrekullueshme.

- Më detyroni shumë!

- Kjo vetëm siguron respektin tim, tha Uinterborni.

- Dhe, ju lutem shumë, kush e siguron të sajin?

- Sa e sertë jeni! - tha djaloshi. - Ajo është goxha vajzë.

---

[3] *Tout bonnemet – Gjithçka mire (frëngj.)*

- E thoni si diçka që nuk e besoni, - vërejti zonja Kostello.

- Është plotësisht e papërpunuar, vazhdoi Uinterborni. - Por është mrekullisht e bukur: shkurt, është e shkëlqyer. Për ta vërtetuar se besoj te këto që thashë, do ta çoj te Kështjella e Shilonit.

- Do të shkoni atje së bashku? Unë them se do të ndodhë e kundërta. Mund t'ju pyes, prej sa kohësh e njihni, që paska marrë formë ky projekt kaq interesant? Ju nuk keni as njëzet e katër orë këtu.

- E kam njohur vetëm gjysmë ore, - buzëqeshi Uinterbomi.

- O Zot! - thirri zonja Kostello. - Çfarë vajze e tmerrshme!

I nipi heshti për disa çaste.

- Vërtet, mendoni që... filloi ai gjithë zell e dëshirë për të marrë të dhëna më të besueshme, - vërtet, mendoni që...

Heshti përsëri.

- Mendoj çfarë, zotëri? - tha tezja.

- Që ajo është nga ai lloj vajzash, të cilat presin, herët a vonë, t'i rrëmbejë një burrë?

- Unë nuk e kam idenë se çfarë presin këto vajza nga një burrë. Veçse mendoj që nuk duhet të përziheni me vajza amerikane të papërpunuara, siç i quani ju. Keni jetuar tepër gjatë larg vendit dhe duhet të jeni i sigurt se do të bëni gabime të mëdha. Jeni tepër i çiltër.

- E dashur teze, nuk jam edhe aq i çiitër, buzëqeshi Uinterborni, duke përdredhur mustaqet.

- Mos jeni tepër fajtor, kështu?

Uinterborni vazhdonte të përdridhte mustaqet mendueshëm.

- Pra, nuk do ta lini të shkretën vajzën që t'ju njohë? - pyeti më në fund.

- Më thuaj, a është e vërtetë që do të vijë me ty te Kështjella e Shilonit?

- Them se ka pikërisht këtë mendim.

- Atëherë, Frederiku im i dashur, - tha zonja Kostello, - unë nuk do ta pranoj nderin e njohjes me të. Jam plakë, por, falë Zotit, jo aq sa të mos provoj tronditje.

- Po, në Amerikë, a nuk bëjnë të gjitha vajzat kështu? - e ngacmoi Uinterborni. Zonja Kostello hapi sytë për një çast.

- Do të doja të shihja mbesat e mia, duke bërë kështu! - shpalli në një mënyrë shumë serioze.

Kjo nuk hidhte ndonjë farë dritë mbi çështjen, sepse Uinterborni kishte dëgjuar se kushërirat e tij bukuroshe në Nju Jork ishin tmerrësisht të hedhura. Nëse Deizi Miler shkonte përtej kufirit të lejuar të këtyre zonjushave, atëherë, vërtet, mund të prftej diçka prej saj. Nuk i pritej derisa ta shihte dhe ge nxehur me veten se, instinktivisht, arrinte ta kuptonte që nuk e vlerësonte drejt.

Megjithëse qe i paduruar për ta takuar, ai qe i sigurt se nuk do të dinte çfarë t'i thoshte për mospranimin e tezes, por zbuloi sakaq se ky ngurrim nuk qe i nevojshëm. E gjeti atë mbrëmje në kopsht, duke u endur nën dritën e ngrohtë të: yjeve, si një shtojzovalle e plogët dhe duke tundur fireskoren më të madhe që i kishin parë sytë. Ishte ora dhjetë. Kishte ngrënë darkë me tezen, kishte qëndruar me të edhe pak, pastaj qenë ndarë për t'u takuar të nesërmen. Zonjusha Deizi Miler u duk shumë e gëzuar që po e takonte, sepse, siç tha, ajo kishte qenë mbrëmja më e gjatë që kishte kaluar ndonjëherë.

- Keni qenë gjithë kohën vetëm? - e pyeti ai.

- Shëtita me nënën, por ajo u lodh, - u përgjigj vajza.

- Ajo shkoi për të fjetur?

- Jo. Asaj nuk i pëlqen të flejë, - tha vajza. - Ajo nuk fle as tri orë. Thotë se as ajo vetë nuk e di se si jeton. Është tmerrësisht nevrike. Në fakt, unë them se ajo fle më shumë se sa i duket. Iku pas Randolfit, që ta vërë në gjumë. As atij nuk i pëlqen të shkojë në shtrat.

- Të shpresojmë se do ta bindë, - tha djaloshi.

- Ajo do t'i flasë gjithë kohën, por ai nuk do t'ia vërë veshin, - tha Deizi Miler, duke hapur freskoren. Pastaj ajo do të shkojë t'i flasë Eugjenios, por Randolfi nuk trembet as prej tij. Eugjenio është një shoqërues i shkëlqyer, por as ai nuk e tërheq dot vëmendjen e Randolfit. Nuk besoj se do shkojë në shtrat para orës njëmbëdhjetë.

Dukej se pagjumësia e Randolfit qe tepër e stërzgjatur, sepse Uinterborni dhe vajza ecën poshtë e lart për një kohë të gjatë, pa u takuar me nënën.

- E mësova se kush është zonja që do të më prezantoni, - rifilloi vajza. - Ajo është tezja juaj.

Kur Uinterborni pohoi dhe shprehu kureshtje se si e kishte mësuar këtë gjë, ajo tha se kishte mësuar gjithçka nga pastruesja. Sipas saj, zonja Kostello ishte shurnë e qetë dhe *comme il faut*[4], përdorte pudër, nuk fliste me askënd dhe nuk hante kurrë në *table d'hote*[5]. Ndërsa çdo dy ditë kishte dhimbje koke.

- Mendoj se është një përshkrim i këndshëm, me dhimbje koke e të githa të tjerat, - tha zonjusha Deizi, me zërin e hollë e të gëzueshëm. - Dua kaq shumë ta njoh. E kuptoj se çfarë do të jetë tezja juaj: e di mirë se do ta pëlqej. Ajo do të jetë nga ato që i përzgjedhin njerëzit. I pëlqej shurnë zonjat që dinë t'i përzgjedhin njerëzit. Unë vdes që t'i përzgjedh njerëzit. Të tilla jemi dhe unë e nëna. Nuk i flasim kujt ose nuk na flasin ne, që mendoj se është e njëjta gjë. Me shurnë kënaqësi do ta njihja tezen tuaj.

Uinterborni qe zënë ngusht.

- Edhe ajo do të jetë shumë e lumtur, - tha ai, - por këto dhimbjet e kokës do të jenë pengesë.

Vajza e pa nëpër gjysmerrësirë.

---

[4] *Comme il faut – E përkryer (frëngj.)*

[5] *Table d'hote – Restoranti i një hoteli (frëngj.)*

- Shpresoj se nuk do të ketë përditë dhirnbje koke, - tha ajo me dhembshuri.

Uinterborni heshti për një çast.

- Në fakt, më tha se ka, u përgjigj ai më në fund - duke mos ditur çfarë të thoshte tjetër.

Zonjusha Deizi Miler qëndroi dhe ia nguli sytë. Hiret e saj qenë edhe më të dukshme në errësirë, tek hapte dhe mbyllte erashkën e stërmadhe.

- Ajo nuk dashka të rnë njohë! - tha befas. - Pse nuk ma thoni? S'keni pse frikësoheni. Unë për vete nuk frikësohem.

Dhe ia dha një të qeshure të lehtë. Uinterborni kapi një drithërimë në zërin e saj, prandaj u ndie shumë i sikletosur dhe i zënë ngushtë.

- Zonjusha ime e dashur, - kundërshtoi ai, - ajo është kundër njohjeve, sepse ka një shëndet për të ardhur keq.

Vajza bëri disa hapa, duke vazhduar të qeshë.

- S'keni pse frikësoheni, - përsëriti. - E pse u dashka të më njohë?

Heshti përsëri, tashti ishte pikërisht pranë parmakut të kopshtit, përballë licienit të përmbytur nga drita e yjeve. Liqeni vezullonte vagullt, ndërsa në largësi nxinin format e maleve. Deizi Miler ia mbërtheu shikimin pamjes misterioze dhe pastaj ia dha një tjetër të qeshure të lehtë.

- Sa çudi! Ajo i përzgjedh njerëzit, - tha.

Uinterborni pyeti veten nëse ajo me të vërtetë ishte lënduar dhe për një çast do të donte të ishte pikërisht kështu, që ai ta ngushëllonte dhe ta qetësonte. Pati ndjesinë e këndshme se ajo i mirëpriste ngushëllimet e tij. E ndjeu se, për një çast, ishte gati të sakrifikonte tezen, të thoshte që ajo ishte një grua e sertë e krenare dhe s'e nuk çonin peshë mendimet e saj. Përpara se të arrinte këtë përzierje të rrezikshme

guximi dhe mosrespektimi, zonjusha rifilloi ecjen dhe lëshoi një pasthirrmë me një ton krejt tjetër.

- Ja, pra, ku është nëna. Them se nuk e ka vënë Randolfin në gjumë.

Nga larg u duk figura e një zonje, jo fort e kapshme në errësirë, e cila afrohej me një lëvizje të ngadaltë dhe ngurruese.

- A jeni e sigurt se është nëna juaj? A mund ta shquani në një errësirë të tillë? - pyeti Uinterborni.

- Epo! - thirri me të qeshur Deizi Miler. - Mendoj se e njoh nënën time. Për më tepër, kur ajo vë shallin tim. Gjithmonë vesh gjërat e mia.

Gruaja për të cilën po flitej, nuk bëri asnjë hap më tep, duke qëndruar aty ku ishte.

- Kam frikë se nëna juaj nuk po ju sheh, - tha Uinterborni. Duke menduar se mund të bënte një shaka me zonjushën, shtoi: - Apo, ndoshta, i vjen turp për shallin!

- Oh, është diçka pa vlerë tashmë! I kam thënë unë që ta veshë. Tashti nuk afrohet, sepse ju ka parë juve.

- Atëherë, - tha Uinterborni, - është më mirë që unë të largohem.

- Jo, jo, rrini, - këmbëngull Deizi Miler.

- Kam frikë se asaj nuk i pëlqen t'ju shohë të shoqëruar me mua. Zonjusha Miler i hodhi një shikim serioz.

- Nuk e ka me mua, e ka me ju, domethënë me veten. Sidoqoftë, nuk e di se me kë e ka. Ime më nuk parapëlqen asnjë prej miqve të mi. Është shumë e druajtur. Gjithmonë nevrikoset, nëse i paraqes ndonjë prej tyre, por unë i prezantoj ata gjithmonë, pothuajse gjithmonë. Nëse nuk ia prezantoj asaj miqtë e mi, - shtoi vajza, me zërin e butë e të njëtrajtshëm, - mendoj se nuk jam në rregull me veten.

- Që të më prezantoni mua, - tha Uinterborni, - më parë duhet të ma dini emrin.

Dhe ia shqiptoi.

- O Zot, po unë nuk e them dot gjithë këtë emër! - qeshi bashkëbiseduesja.

Ndërkaq, u nisën drejt zonjës Miler, e cila, kur ata iu afruan, shkoi pranë parmakut të kopshtit, u përkul mbi të dhe, pasi u ktheu shpinën me qëllim, filloi të shikojë nga liqeni.

- Nënë! - thirri vajza, me ton të vendosur.

Zonja ktheu kokën.

- Zoti Uinterborn, - tha vajza, duke e paraqitur djaloshin gjithë sinqeritet dhe hir.

"E rëndomtë" ishte, siç pat thënë zonja Kostello, por Uinterborni mrekullohej nga shprehitë e saj të veçanta e delikate. Nëna e saj qe një grua e shkurtër dhe e imët, me sy të përhumbur e hundë të vogël, si dhe një ballë të gjerë, zbukuruar me një cullufe flokësh kaçurrela. Si dhe e bija, cie veshur me shumë elegancë, ndërsa në veshë mbante diamante të mëdha. Për sa mundi të dallojë Uinterborni, ajo nuk e përshëndeti, madje as nuk ia hodhi sytë. Deizi tashti ishte pranë saj dhe po i rregullonte shallin.

- Çfarë kërkon këtu? - e pyeti, por jo me tonin e rreptë që mund të kenë këto fjalë.

- Nuk e di, - tha e ëma, duke u kthyer përsëri nga liqeni.

- Nuk e dija se të tërhiqte ky shall, thirri Deizi.

- Ja që po, u përgjigj e ëma, me një qeshje të lehtë.

- A fjeti Randolfi? pyeti vajza.

- Nuk e binda dot, - ia ktheu e ëma gjithë mirësjellje. - Do të flasë me kamerierin. I pëlqen shumë të bisedojë me atë kamerier.

- Sa po i tregoja Uinterbornit, - vazhdoi vajza dhe në veshët e djaloshit toni i saj erdhi në një mënyrë sikur kishte një jetë që ia shqiptonte emrin.

- Oh, po, - tha djaloshi, - kam kënaqësinë ta njoh djalin tuaj.

Mamaja e Randolfit heshti dhe u përqendrua te liqeni.

Dikur foli:

- Nuk e di se si jeton ai fëmijë!

- Sidoqoftë, nuk është puna aq keq sa në Dover, - tha Deizi Miler.

- Çfarë ndodhi në Dover? - pyeti Uinterborni.

- As atje nuk donte të shkonte në shtrat. Them se ndenji gjithë natën në një sallon. Nuk shkoi në shtrat as nga ora dymbëdhjetë.

- Ishte dymbëdhjetë e gjysmë, - ia ktheu zonja Miler, me një theks të butë.

- A mos ka fjetur shumë gjatë ditës? - pyeti Uinterborni.

- Mendoj se jo, - iu përgjigj Deizi.

- Sa do të doja të flinte, - tha e ërna. - Po ai nuk ia arrin.

- Mendoj se është shumë i lodhshëm, - ndërhyri Deizi.

Disa çaste pasoi qetësia. - Deizi Miler, - tha zonja e vjetër, - mos po shprehesh kundër vëllait?

- Po është i lodhshëm, moj nënë, - tha Deizi, pa shprehur ndonjë ashpërsi në përgjigje.

- Është vetëm nëntë vjeç, - u shpreh e ëma.

- Nuk i pëlqen as të shkojë te kështjella, tha vajza. - Unë do të shkoj atje me zotin Uinterborn.

Kësaj deklarate, të shprehur shumë thjesht, nëna e Deizit nuk i dha përgjigje. Uinterborni këtë e mori si mosaprovim, por, meqë ajo grua i dukej e thjeshtë dhe e manovrueshme, mund t'ia merrte mendjen me ca fjalë të bukura.

- Vajza juaj, - i tha, - më ka dhënë kënaqësinë që të jem shoqëruesi i saj.

Shikimi i përhumbur i zonjës Miler ra mbi Deizin, sikur po i kërkonte ndihmë, por ajo bëri disa hapa më tej, duke ia marrë nën zë një kënge.

- Them se do të shkoni me karrocë, - tha nëna.

- Me karrocë ose me avullore, - ia ktheu Uinterborni.

- Nuk di ç't'ju them për këtë, tha zonja Miler. - Nuk kam qenë asnjëherë te ajo kështjellë.

- Sa keq që nuk keni qenë, - tha Uinterborni, i cili filloi të kuptojë se ajo nuk do të shfaqte ndonjë kundërshtim.

Sidoqoftë, ai besonte se qe e sigurt që ajo do t'i shoqëronte.

- Menduam disa herë që të shkonim, - vazhdoi ajo, - por ja që nuk ia dolërn. Deizi po, sepse asaj i pëlqen të shëtisë. Një zonjë, që nuk ia di emrin, thotë se nuk është nevoja të vizitojmë kështjellat e këtushme, por të presim deri sa të shkojmë në Itali. Duket se atje do të ketë më shumë kështjella, - e mbylli ajo me një ton mirëbesues në rritje. - Duam që të shikojrnë ato më kryesoret. I vizituam disa në Angli.

- Ah, po! në Angli ka kështjella të mrekullueshme, - tha Uinterborni. - Por është mirë të shihet edhe kjo e Shilonit.

- Nëse Deizi është e ndjeshme ndaj kësaj, s'jam kundër, - tha zonja Miler, me një ton të mbarsur me rëndësinë e planit. - Deizi nuk njeh pengesa në sipërmarrjet e saj.

- Oh, unë mendoj se ajo do të kënaqet! - tha Uinterborni.

Ai po mbushej me dëshirën për ta bërë të sigurt një ndenjje *tête-a-tête* me vajzën, e cila vazhdonte të endej përballë tyre, duke kënduar nën zë një melodi.

- Po ju, zonjë, - ndërhyri Uinterborni, - a nuk do të vini?

Nëna e Deizit pa një çast nga ai, si me dyshim dhe, më pas, bëri përpara e heshtur. Pas pak, tha thjesht:

- Them se është më mirë të vijë vetëm.

Uinterborni vërejti se ajo ishte ndryshe nga tipi i nënave vigjilente, që grupoheshin në qendrën e njohjeve shoqërore në pjesën e vjetër të qytetit, matanë liqenit. Por meditimet e tij u ndërprenë, kur dëgjoi t'i shqiptohej emri nga vajza e pambrojtur e zonjës Miler.

- Zoti Uinterborn! - murmuriti Deizi.

- Zonjushë? - tha djaloshi.

- A nuk më shëtisni me një varkë?

- Tashti? - pyeti ai.

- Tashti, ia ktheu ajo.

- Oh, Ani Miler! - i thirri e ëma.

- Ju lutem, zonjë, lejojeni, tha Uinterborni gjithë pasion, sepse kurrë më parë nuk kishte shijuar një udhëtim me varkë nën dritën e yjeve verorë, së bashku me një vajzë të njomë dhe të bukur.

- Unë mendoj se nuk do t'i pëlqejë kjo, - tha nëna e vajzës. Them se ajo do të kthehet në hotel tashti.

- Unë jam e sigurt se zoti Uinterborn do të më shëtisë tashti, - tha Deizi. - Ai është kaq i gatshëm.

- Do të vozitim për në Shilon, natën me hënë.

- Nuk ju besoj, - tha Deizi.

- Eh! - i doli nënës.

- Keni gjysmë ore që nuk më thoni asnjë fjalë, - vazhdoi Deizi.

- Kisha një bisedë të këndshme me nënën tuaj.

- Sidoqoftë, unë dua të më shëtitni me varkë! - përsëriti vajza.

Të gjithë kishin mbetur në vend, ndërsa Deizi u kthye nga Uinterborni. Fytyra e saj qe bërë shumë joshëse, me ato sytë që i shndrinin dhe freskoren në dorë. E pamundur të ketë diçka më të bukur, mendoi Uinterborni.

- Ka, disa barka në mol, - tha ai, duke treguar shkallët që zbrisnin nga kopshti në liqen. Nëse kam nderin që të më kapni nga krahu, do të shkojmë të zgjedhim njërën prej tyre.

Deizi, po buzëqeshte atje tej, i dha kokës prapa dhe ia dha një të qeshure.

- Më pëlqejnë burrat kaq bujarë, - tha Deizi.

- Ju siguroj për bujarinë time.

- Isha e bindur se do të thoshit pikrisht këto fjalë, - vazhdoi Deizi.

- Siç e shihni, nuk është aspak e vështirë për mua, por kam frikë se po e bëni vetëm për të më ngacmuar.

- Nuk mund ta merrni ashtu, - vërejti gjithë mirësjellje zonja Miler.

- Le të vozitim, atëherë, - i tha ai vajzës.

- E thoni kaq bukur! - thirri Deizi.

- Do të qe edhe më e bukur, po ta bënim.

- Nuk kam asnjë dyshim për këtë, - tha Deizi.

Por as që lëvizi nga vendi dhe vetm qeshte.

- Do të bëje mirë të dije se sa ka shkuar ora, ndërhyri nëna.

- Ora është njëmbëdhjetë, madam, - erdhi një zë me theks të huaj, që nga errësira dhe Uinterborni dalloi atë tipin e pispillosur që shoqëronte zonjat.

Qe afruar fare pranë.

- Oh, Eugjenio, - thirri Deizi, - unë do të bëj tashti një shëtitje me barkë.

Eugjenio bëri një përkulje.

- Tashti, në njëmbëdhjetë të natës, mademoiselle?

- Do të shkoj me Uinterbornin. Pikërisht tashti.

- I thoni se nuk mund të shkojë në këtë orë, - i tha gruaja shoqëruesit.

- Mendoj se nuk është mirë të vozitni tani, - tha Eugjenio.

Uinterborni iu lut Zotit që kjo vajzë të mos ishte e afërt me shoqëruesin, për nuk tha ndonjë gjë.

- Ju gjykoni se kjo nuk është gjë e mirë, e ngriti zërin vajza. - Eugjenio është kundër gjithçkaje.

- Unë jam në shërbimin tuaj, tha Uinterborni.

- Zonjusha kërkon të shkojë vetëm? - e pyeti Eugjenio zonjën Miler.

- Oh, jo. Do të shkojë me këtë zotërinë, - u përgjigj nëna e Deizit.

Shoqëruesi i hodhi një vështrim Uinterbornit këtij iu duk se ai po buzëqeshte - mandej, seriozisht dhe duke u përkulur, tha:

- Si të dëshirojë zonjusha!

- Oh, unë kujtova se do ta bënit të madhe! - tha Deizi. - Tashti nuk dua të shkoj.

- Do ta bëj unë të madhe, nëse nuk vini, - tha Uinterborni.

- Kjo është ajo që dua, një trazirë të vogël!

Vajza filloi përsëri të qeshte.

- Zoti Randolf fjeti, - raportoi ftohtë shoqëruesi.

- Deizi, është koha të shkojmë edhe ne, tha nëna.

Deizi u kthye nga Uinterborni, duke buzëqeshur dhe duke tundur freskoren.

- Natën e mirë! - i tha. - Shpresoj të jeni zhgënjyer, t'ju jetë prishur gjithë humori, a diçka e tillë.

Ai e vështronte, ndërsa i shtrëngonte dorën.

- Nuk kuptova asgjë, u përgjigj.

- Shpresoj të bëni gjumë, siç duhet, - e ngacmoi vajzën.

Nën shoqërinë e Eugjenios, dy gratë u nisën drejt hotelit. Uinterborni i shoqëronte me ishte i paaftë për të kuptuar diçka. Qëndroi pranë liqenit për një çerek ore, duke ripërtypur misterin e ngacmimeve dhe trilleve të vajzës. I vetmi përcaktim i qartë në kokën e tij, ishte se do t'i gëzohej si djalli një "ikjeje" me të.

Në kështjellën e Shilonit shkuan pas dy ditësh.

E priti në hollin e madh të hotelit, ku shoqëruesit, shërbëtorët dhe turistët, silleshin kot dhe shikonin. Nuk e kishte zgjedhur ai vendin, këtë e kishte bërë vajza. Ajo erdhi, duke zbritur gjithë shkëlqim

shkallët, duke mbërthyer dorashkat, duke shtrënguar pas trupit të bukur çadrën e pahapur, e veshur në mënyrë të përsosur me një rrobë elegante udhëtimi. Uinterborni qe njeri me imagjinatë dhe, siç thonë paraardhësit tanë, i ndjeshëm: tek shihte fustanin e saj, mbi shkallën e madhe, hapin e shpejtë e të sigurt, ndjeu se po e priste diçka romantike. Dukej sikur po shkonte të zhdukej diku larg me të. Përshkuan rrethin e njerëzve të ngeshëm, të cilët sikur donin ta hanin me sy vajzën që filloi të cicërinte pa fund, menjëherë pasi u takuan. Uinterborni kishte menduar cië të shkonin në Shilon me karrocë, por ajo, gjithë gjallëri, i tha se donte të shkonte me një avullore të vogël, pasi i donte shumë ato: gjithmonë fryn një fllad i këndshëm dhe të zë syri shumë njerëz. Udhëtimi nuk qe i gjatë, por ajo gjeti kohë për të thënë aq shumë gjëra. Për Uinterbornin vetë, ai udhëtim i vogël qe një arratisje, një aventurë, duke besuar se edhe ajo duhej ta shihte në të njëjtën mënyrë, mirëpo, duhet thënë që nuk i doli ashtu si e mendonte. Deizi Miler ishte gjithë fjalë, tepër joshëse, por aspak e eksituar: nuk dridhej, nuk u shmangej shikimit të ij apo të tjerëve, nuk skuqej as kur shihte atë, as kur e shihnin njerëzit. Njerëzit vazhdonin t'i shihnin gjithnjë e më shumë dhe Uinterborni kënaqej nga pamja e veçantë e shoqërueses së tij të bukur. Pati frikë se ajo do të fliste me zë të lartë, do të qeshte më shumë se duhej dhe, ndoshta, do t'i rritej dëshira që të lëvizte nëpër kuvertë, por, pas pak, ai i harroi këto lloj mendimesh: rrinte buzagaz, ndërsa ajo, pa luajtur nga vendi, hidhte pareshtur mendime krejt të vetat. Ishin llafet më magjepsëse që atij i kishin dëgjuar veshët ndonjëherë. Pajtohej me idenë që ishte e "rëndomtë": a ishte e tillë, në fund të fundit, apo ai qe mësuar me rëndomtësinë e saj? Ajo fliste për ato gjëra që metafizikët i quajnë gjëra të përditshmërisë, por, herë pas here, bënte një kthesë subjektive.

- Çfarë ndodhi që u bëtë kaq serioz? - pyeti befas ajo, duke ia ngulur Uinterbornit sytë e këndshëm.

- Unë, serioz?! - ia ktheu ai. - Pata idenë se po qeshja vesh më vesh.

Dukeni sikur po më çoni në një funeral. Nëse kjo quhet qeshje, atëherë veshët tuaj janë shumë pranë njëri-tjetrit.

- Mos doni t'ju hedh një valle detarësh përmbi tryezë?

- Ah, të lutem, dhe unë do të vij rrotull me një kapelë në dorë. Të paktën, të mbledhim shpenzimet e udhëtimit.

- Kurrë në jetën time nuk kam qenë më i kënaqur, - murmuriti Uinterborni.

Ajo e pa një çast dhe shpërtheu në gaz.

- Më pëlqen që ju bëj të flisni kështu! Shoh diçka të veçantë te ju.

Kur arritën te kështjella, fitoi plotësisht elementi subjektiv. Deizi u lëshua sallave me tavane të larta, duke fështëritur fustanin nëpër shkallët rrotulluese, u zbyth me një klithmë dhe rrëqethje nga bodrumi i burgut dhe mbante vesh mirë çdo gjë që tregonte për atë vend Uinterborni. Por ai pa se ajo interesohej fare pak për objektet e kohëve mesjetare dhe misteret e kështjelks së Shilonit. Patën vetëm shoqërinë e rojtarit dhe Uinterbomi e rregulloi me të që të mos nguteshin: mund të shkonin nga të donin dhe të ndalonin më gjatë ku t'u pëlqente. Rojtari e interpretoi marrëveshjen shumë bujarisht - ashtu siç u soll Uinterborni me të - dhe i la krejt vetëm. Bisedat e zonjushës Miler nuk shquheshin për ndonjë lidhje logjike: kishte arsyet e saj kur fliste për diçka. Në frëngjitë muretrasha të kështjellës, befas, pyeti drejtpërdrejt për gjërat e Uinterbornit vetë - familjen, të kaluarën, shijet, zakonet, planet - prej ku duhej të dilnin pikat që përkonin me të dhëna për personalitetin e saj. Sa për shijet, zakonet dhe planet e veta, qe e përgatitur për t'i rrëfyer hollësisht, veçanërisht ato më pozitivet.

- Sa shumë gjëra që dini! - i tha bashkëbiseduesit, kur ky i tregoi historinë e fatkeqit Bonivard. - Kurrë nuk kam ndeshur një njeri që të dijë kaq shumë!

Ishte shumë e dukshme që kjo histori i hyri nga njëri vesh dhe i doli nga tjetri, megjithatë ajo shtoi se donte që ai të futej në shoqërinë e tyre, ngado të shkonin, kështu që, me këtë rast, edhe ato të mësonin diçka.

- Pse nuk bëheni mësuesi i Randolfit? - e pyeti.

Uinterborni u përgjigj se asgjë nuk do ta kënaqte më shumë se kjo, por, fatkeqësisht, qe i zënë me punë të tjera.

- Punë të tjera? Nuk e besoj këtë që thua! - tha ajo. - Çfarë doni të thoni? Ju nuk keni ndonjë biznes.

Djaloshi pohoi që nuk kishte ndonjë biznes, po kishte takime, për të cilat, brenda një apo dy ditëve, i duhej të kthehej në Gjenevë.

- S'është e mundur! - tha ajo. - Nuk e besoj!

Dhe ndërroi temë. Por pas pak, kur ai po i tregonte pamjen e bukur të një oxhaku të vjetër, ajo e ndërpreu krejt pa lidhje:

- Nuk është e vërtetë që po ktheheni në Gjenevë, apo jo?

- Është një fakt i trishtueshëm, por unë duhet të kthehem në Gjenevë nesër.

- Atëherë, më duhet të them se ju jeni një njeri i lig!

- Nuk duhet të thoni gjëra të tmerrshme, - ia ktheu Uinterborni, - pikërisht tani në fund.

- Në fund! - thirri vajza. - Po ky është vetëm fillimi. Më thotë mendja t'ju lë vetëm e të kthehem menjëherë në hotel.

Për dhjetë minuta nuk bëri gjë tjetër, veçse e quajti "të keq". 1 shkreti Uinterborn u hutua keqas: deri atëherë asnjë femër nuk i kishte dhënë kënaqësinë që të mërzitej vetëm prej lajmit të largimit të tij. Pas kësaj, bashkëbiseduesja nuk tregoi më asnjë vëmendje për kuriozitetet e Shilonit apo bukuritë e ajo hapi zjarr mbi magjistaren e fshehtë të

Gjenevës, për të cilën besonte se bëhej ky kthim kaq i shpejtë. Si e dinte ajo se kishte një femër të tillë në Gjenevë? Uinterborni, i cili e mohoi ekzistencën e një njeriu të nuk ishte i zoti t'i përgjigjej kësaj pyetjeje: ndahej mes befasisë nga shpejtësia e arsyetimeve të saj logjike dhe zbavitjes me sinceritetin e bisedave të lehta të saj. Në gjithë këtë, ajo i dukej një përzierje e jashtëzakonshme e dëlirësisë dhe mungesës së mirësjelljes.

- Nuk ju jep asnjëherë leje më shumë se tre ditë? - pyeti Deizi me ironi. - Nuk ju jep pushime as në verë? Askush nuk punon dot në këtë stinë, të gjithë duan të ikin diku. Them se po të vonoheni edhe një ditë, ajo do t'i behë këtu me një avullore. Prisni deri të premten dhe do të dal unë ta pres!

Uinterborni filloi të mendojë se kishte gabuar që qe zhgënjyer nga karakteri i shfaqur fillimisht prej vajzës. Ai ia kishte mohuar asaj çdo shenjë personale dhe ja ku po i shfaqej rrërnbimthi kjo gjë. Së fundi, iu bë e qartë se nëse do t'i premtonte që do të shkonte në Romë atë dimër, ajo do ta ndërpriste ngacmimin.

- E kam të lehtë të të premtoj - tha Uinterborni. Tezja ka marrë një apartament për dimr në Romë dhe më ka kërkuar të shkoj e ta shoh.

- Nuk dua të vini për tezen, - tha Deizi. - Dua të vini për mua.

Ky qe i vetmi aludim dëgjoi për tezen e vet të padrejtë. I tha se, sidoqoftë, në dimër do të ishte patjetër në Romë. Pas këtij premtimi, Deizi i ndërpreu ngacmimet. Uinterborni mori një karrocë dhe në muzg mbërritën në Vevey, ku vajza, ndërkohë, dukej krejt e qetë.

Në mbrëmje Uinterborni i tha zonjës Kostello se kishte qenë në Shilon me zonjushën Deizi Miler.

- Ato amerikanet... e shoqëruesit? - pyeti kjo zonjë.

- Për fat të mirë, - tha Uinterborni, shoqëruesi nuk erdhi.

- Ajo erdhi me ty, vetëm?

- Krejt vetëm.

Zonja Kostello thithi paksa silishen me kamfur.
- Dhe kjo, - thirri, - qe ajo vajza që deshët të ma prezantoni!

III

Uinterborni, i cili qe kthyer në Gjenevë fill pas udhëtimit të tij në Shilon, u nis për Romë në fund të Janarit. Tezja, e vendosur atje prej disa javësh, i kishte dërguar nja dy letra. Te njëra i shkruante se njerëzit, të cilëve u kisha shërbyer me aq përkushtim verën e kaluar në Vevey, ishin kthyer bashkë me shoqëruesin, i cili, pavarësisht njohjeve të reja që kishin zënë, vazhdonte të ishte më i afërti për to. "Gjithashtu, vazhdonte të shkruante ajo, - zonjusha duket se është mjaft e lidhur me disa italianë të rangut të tretë, me të cilët sorollatet në mënyrë të tillë, sa ka ngjallur mjaft thashetheme". Në fund, ishte porosia për romanin e këndshëm të Cherbuliex-së, Paule Mere dhe kërkesa që të mos shkoja me vonë se data 23.

Normale do të ishte që, me të mbërritur në Romë, Uinterborni të sigurohej për adresën e zonjushës Miler në bankën amerikane dhe t'i bënte një vizitë asaj.

- Pas asaj që ndodhi në Vevey unë, sigurisht, mendoj se duhet t'u shkoj për vizitë. - i tha zonjës Kostello.

- Nëse, pas atyre që ndodhen në Vevey dhe gjithandej, ju doni të vazhdoni t'i ruani lidhjet me to, ju lumtë. Sigurisht, një burrë ka drejtë të njohë këdo. Burrat e kanë këtë përparësi.

- Më thuaj, çfarë ka ndodhur këtu, - iu lut Uinterborni.

- Zonjusha bredh vetëm me të huajt, gjithandej. Duhet të pyesësh në tjetër vend, për të marrë vesh se çfarë ka ndodhur më tej. Ka mbledhur një tufë batakçinjsh romanë, të cilët e kërkojnë fatin në rrugë jo të pastra dhe i shpie në shtëpitë e të tjerëve. Kur shkon në mbrëmje, shihet e shoqëruar me një zotëri shumë të sjellshëm, me një palë mustaqe të hijshme.

- Po e ëma ç'bën?

- S'e kam idenë, por ato janë gra të frikshme.

Uinterborni heshti për një çast.

- Ju siguroj se nuk janë të këqija. Më tepër janë të paditura dhe naive.

- Ato janë pandreqshmërisht të rëndomta. Nëse të qenit pandreqshmërisht i rëndomtë, është e njëjtë me të qenit "i keq", ky problem u takon metafizikëve. Ato janë aq të këqija sa, në çdo rast, të ngjallin neveri dhe, për këtë jetë të shkurtër, kaq mjafton, - tha zonja Kostello.

Lajmi se Deizi Miler shoqërohej me një tufë mustaqellinjsh e pengoi që të shkonte e ta takonte menjëherë. Nuk e kishte përkëdhelur veten aq shumë me mendimin se kishte lënë gjurmë të pashlyeshme në zemrën e saj, por u inatos tepër tek dëgjonte se ishte një situatë aq e papërshtatshme me imazhin që mbizotëronte, së fundmi, në mendimet e tij: ai i një vajze shumë të bukur, që nga dritarja e vjetër romane priste me padurim shfaqjen e tij. Nëse do të vendoste të priste pak, përpara se t'i kujtonte Deizit kërkesën për të pasur vëmendjen e saj, ai, ndërkohë,

mund të shkonte shpejt e të takonte dy-tre miq të tjerë. Njëra prej tyre ishte një zonjë amerikane, që kishte kaluar disa dimra në Gjenevë, meqenëse kishte edhe fëmijët në shkollë atje. Ishte një grua e formuar dhe tani jetonte në Via Gregoriana. Uinterborni e takoi në një dhomë pritjeje të vogël e të kuqe në katin e tretë, e cila shkëlqente nga dielli i jugut. S'kishin kaluar as dhjetë minuta, kur shërbëtorja erdhi dhe tha:

- Zonja Mila!

Ky njoftim u shoqërua me hyrjen e Randolfit të vogël, u ndal në mes të dhomës dhe ia nguli sytë Uinterbornit. Pak më vonë u shfaq në prag motra e tij e bukur, ndërsa, pas një copë here, edhe e ëma.

- Të njoh! - i tha Randolfi.

- Jam i sigurt se ti di shumë gjëra, - thirri Uinterborni, duke e kapur për dore. - Çfarë thonë mësimet?

Deizi po shkëmbente përshëndetje me zonjën e shtëpisë, por, kur dëgjoi zërin e Uinterbornit, e ktheu kokën menjëherë.

- Pa shiko! - thirri.

- Ju premtova, apo jo? - buzëqeshi Uinterborni.

- Nuk ju besova, - ia ktheu zonjusha Deizi.

- Ju detyrohem shumë, - qeshi djaloshi.

- Pse s'më takuat?

- Arrita dje.

- Nuk ju besoj, u shpreh vajza.

Uinterborni, me një buzëqeshje protestuese, u kthe nga nëna e saj, por gruaja, që i'u shmang atij vështrimi, u ul dhe ia nguli sytë të birit.

- Ne kemi një shtëpi më të madhe se sa kjo, tha Randolfi. - Muret e saj janë gjithë ar.

Zonja Miler lëvizi e shqetësuar në karrige.

- Të porosita se nuk duhet të flasësh nga këto, i murmuriti.

- Të thashë! - thirri Randolfi. - Po jua them, zotëri, - shtoi me një mënyrë humori, duke i dhënë Uinterbornit një goditje në gju, - ajo është edhe më e madhe, madje!

Ndërsa Deizi kishte filluar një bisedë të gjallë me mikpritësen e saj, Uinterborni mendoi t'i fliste së ëmës, zonjës Miler.

- Shpresoj të keni qenë mirë, që nga koha kur u ndamë në Vevey, - i tha.

Zonja Miler këtë herë e pa.

- Jo dhe aq mirë, ia ktheu ajo.

- Ka *dispepsi*[6] , - tha Randolfi. - Si dhe unë. Edhe babai ka. Po sidomos unë.

Ky njoftim, në fakt, e nxori nga sikleti zonjën Miler.

- Vuaj nga mëlçia, - tha. - Mendoj se vjen nga klima, e cila ndryshon nga ajo e Skinkteidit, sidomos në stinën e dimrit. Nuk e di nëse e keni mësuar se ne jetojmë në Skinkteidi. Po i thosha Deizit se nuk mund të gjej një doktor si Dejvis. Në Skinkteidi është numri një, kështu e quajnë të gjithë. Ai ka shumë punë, por prapëseprapë, më gjendet gjithmonë. Thotë se nuk ka parë dispepsi si e imja, megjithatë është i gatshëm për të më shëruar. Do të bëjë të pamundurën, sigurisht. Po më bënte gati një ilaç të ri, por ne u nisëm për në Evropë. Zoti Miler donte që Deizi t'i shihte këto vende. I shkrova tim shoqi se unë nuk mund ta bëja këtë udhëtirn pa praninë e doktor Dejvisit, mirëpo ai është numri një në një vend ku ka shumë sëmundje. Dispepsia më shkakton edhe pagjumësi.

Gjatë kohës që Uinterborni mbushej me llomotitjen e pacientes së doktor Dejvisit, Deizi s'pushonte së foluri me mikpritësen e vet. Djaloshi pyeti zonjën Miler nëse i pëlqente Roma.

---

[6] *Dispepsi – Sëmundje stomaku.*

- Më duhet të them se jam zhgënjyer, - iu përgjigj ajo. - Kishim dëgjuar shumë për të, ndoshta më tepër se duhet. E kjo s'na bëri mirë. Ishim përgatitur për diçka tjetër.

- Edhe pak dhe do t'ju pëlqejë, - tha Uinterborni.

- Unë e urrej gjithnjë e më shumë, - thirri Randolfi.

- Ju jeni një Hanibal i vogël, - tha Uinterborni.

- Jo, nuk jam, - ia këputi Randolfi.

- Ti nuk je si shumë fëmijë të tjerë, - tha e ëma. - Ne kemi parë shumë vende që do t'i vija para Romës. - Si përgjigje për atë që tha Uinterborni, shtoi: - Ja, është Zyrihu. Është aq i këndshëm dhe nuk kishim dëgjuar për të as gjysmën e atyre që dëgjuam për Romën.

- Vendi më i bukur që kemi parë, është City of Richmond, - tha Randolfi.

- E ka fjalën për anijen, - shpjegoi e ërna. - Me të erdhëm në Evropë. Randolfi u kënaq shumë aty.

- Është vendi më i bukur që kam parë, përsëriti fëmija. - Vetëm se ajo u kthye mbrapsht.

- Ndonjëherë do të kthehemi nga e mbara, - vuri buzën në gaz e ëma.

Uinterborni u shpreh se të paktën e bija duhet të kishte gjetur diçka kau dhe gruaja ia ktheu se me Deizin ishte ndryshe puna.

- Për shkak të shoqërisë që ka gjetur: një shoqëri e mrekullueshrne. Hyn e del gjithandej dhe ka bërë shumë njohje. Sigurisht, ajo lëviz më shumë nga unë. Më duhet të them se njerëzit qenë shumë të shoqërueshëm dhe e pranuan menjëherë mes tyre. Njohu shumë zotërinj. Oh, ajo mendon se nuk ka si Roma! Sigurisht, për një vajzë të re është mrekulli kur njeh shumë zotërinj.

Prej këtij çasti, Deizi filloi të tregojë vëmendje për Uinterbornin.

- Po i tregoja zonjës Uoker për ju, - tha vajza.

- Dhe çfarë qe ajo që i thatë? - pyeti Uinterborni, i mërzitur fort që ajo nuk vlerësonte përkushtimin e një admiruesi, i cili, në rrugën e tij për në Romë, nuk kishte ndaluar as në Bolonja, as në Firence, vetëm nga padurimi sentimental. Iu kujtua thënia e një bashkatdhetari cinik, cili i kishte thënë se vajzat amerikane ato të bukurat, gjë që e begatonte thënien - janë më të vështirat në botë ose, së paku, më të pajisurat me ndjenjën e mbizotërimit.

- Që qetë aq i keq në Vevey, - tha Deizi. - Që nuk bëtë asgjë për mua. Që nuk qëndruat, kur jua kërkova,

- Zonjushë e dashur, - thirri Uinterborni me një të folur të stërholluar, - për këto kritika erdha deri në Romë?

- Pa dëgjojeni, - i tha Deizi zonjës së shtëpisë, duke i përdredhur një rrip te fustani. - A keni dëgjuar ndonjëherë gjëra si këto?

- Gjëra si këto, e dashura ime? - murmuriti zonja Uoker me ton të dukshëm në anën e Uinterbornit.

- Eh, nuk e di, - tha Deizi, duke vazhduar të luante me gishta në rripat e zonjës Uoker. - Zonja Uoker, a mund t'ju them diçka?

- Mamaaa, - ndërhyri Randolfi, duke e theksuar fundin e fjalës, - na duhet të shkojmë. Eugjenio do të bëjë namin.

- Nuk i trembem Eugjenios, - tha Deizi, duke tundur kokën dhe vazhdoi. - Zonja Uoker, e dini se do të vij në mbrëmjen tuaj?

- Gëzohem shumë për këtë.

- Do të vesh një fustan shumë të bukur.

- Nuk kam asnjë dyshim.

- Por ju kërkoj një nder: dua të vij me një mik.

- Do të më pëlqejë shumë që të shoh ndonjë mikun tuaj, - tha zonja Uoker, duke u kthyer buzagaz nga zonja Miler.

- Oh, ata nuk janë miqtë e mi, - u përgjigj e ëma e Deizit, pak në siklet. - Nuk kam folur kurrë me ta.

- Është një miku im i ngushtë, zoti Xhovaneli, - tha Deizi, pa iu dridhur zëri dhe pa i lëvizur që në fytyrën gjithë dritë.

Zonja Uoker heshti një çast, pastaj i hodhi një vështrim të shpejtë Uinterbornit.

- Do ta njoh me kënaqësi zotin Xvnovaneli, - tha më në fund.

- Është italian, - vazhdoi Deizi, me të njëjtën qetësi. - Është miku im i madh dhe burri më i pashëm në botë, duke përjashtuar Uinterbornin. Ka njohje pa fund me italianë, por i pëlqen të njohë edhe amerikanë. Nuk i heq nga mendja. Është tepër i zgjuar dhe simpatik.

Pasi u vendos që ky personazh i shkëlqyer të vinte në mbrëmje, zonja Miler u ngrit.

- Duhet të kthehemi në hotel, - tha.

- Mund të shkoni, nënë, - tha Deizi, - se unë unë dua të bëj një shëtitje.

- Do të bëjë shëtitje me zotin Xhovaneli, - tha Randolfi.

- Do të shkoj në Pincio, - buzëqeshi Deizi.

- Vetëm, në këtë orë, e dashura ime? - pyeti zonja Uoker.

Pasditja po i linte vendin mbrëmjes, kur do të vërshonin karrocat dhe këmbësorët vetmitarë.

- S'është pa rrezik, e dashura ime, - shtoi zonja Uoker.

- Ashtu është, - iu bashkua zonja Miler. - Dhe, me siguri, do të merrni ndonjë ethe. Kujtoni çfarë ju ka thënë doktor Dejvisi.

- Jepi ndonjë ilaç me vete, - tha Randolfi.

U ngritën të gjithë. Deizi, duke treguar dhëmbët bardhë, u zgjat dhe puthi zonjën e shtëpisë.

- Jeni tepër e mirë, - tha. - Nuk do të jem vetëm. Do të takoj një mik.

- Miku nuk do t'jua ndalojë ethet, - vërejti zonja Miler.

- Mos është Xhovaneli? - pyeti e zonja e shtëpisë.

Uinterborni pa nga vajza, sepse pyetja e fundit ia zgjoi vëmendjen. Deizi buzëqeshte edhe, ndërsa rregullonte kordelet e kapelës, i hodhi një shikim Uinterbornit. Kështu, duke buzëqeshur e duke hedhur shikime, ajo u përgjigj, pa pikë ngurrimi:

- Zoti. Xhovaneli, i këndshmi Xhovaneli.

- E dashura, mikja e vogël, - tha zonja Uoker, duke ia marrë dorën gjithë lutje, mos shkoni në këtë orë në Pincio, për të takuar një italian të këndshëm.

- Ai flet anglisht, tha zonja Miler.

- O Zot! - thirri Deizi. Nuk dua të bëj gjëra të papëlqyeshme. Është e mundshme të rregullohet gjithçka, - vazhdoi duke i hedhur një shikim Uinterbornit. - Pincio është vetëm njëqind jardë prej këtu dhe, nëse zoti Uinterborn është aq i sjellshëm sa ç'hiqet, do të më shoqëronte.

Mirësjellja e Uinterbornit u vu në veprim menjëherë dhe vajza i ofroi shoqërinë e saj. Përshkuan shkallët, përpara nënës së saj, dhe Uinterborni pa poshtë karrocën e zonjës Miler, brenda së cilës rrinte shoqëruesi i pispillosur, që kishte njohur në Vevey.

- Mirupafshim, Eugjenio! - i thirri Deizi. - Po dal për një shëtitje.

Në fakt, largësia nga Via Gregoriana, te ana tjetër e kodrës së Pincios, përshkohej shumë shpejt. Megjithëse qe ditë e bukur, rrëmuja e karrocave, e atyre që varavingeshin dhe njerëzve të ngeshëm, nuk i la të rinjtë të ecnin shpejt. Kjo i bëri shumë përshtypje Uinterbornit, megjithëse qe i vetëdijshëm për situatën e vet të pazakonshme. Turma e ngadaltë romane, që shihte me përtaci, tregonte vëmendje të veçantë për bukuroshen e huaj, aty në krah të tij dhe ai deshi të dinte ç'i kishte thënë mendja Deizit, kur pati idenë të ekspozohej e pashoqëruar para një turme si kjo. Detyra e tij, me ç'kishte kuptuar, ishte ta dorëzonte atë në

duart zotit Xhovaneli, por Uinterborni, i inatosur dhe i gëzuar njëherësh, vendosi që të mos e bënte një gjë të tillë.

- Përse nuk erdhët të më takoni? - pyeti Deizi. - Nuk mund të gjeni ndonjë shfajësim.

- Pata nderin t'ju them se sapo zbrita nga treni.

- Duhet të keni qëndruar në tren edhe shumë kohë pasi mbërritët, - thirri vajza gjithë gaz. - Me sa duket, ju kishte zënë gjumi. Por patët kohë, sa të shihnit zonjën Uoker.

- Zonjën Uoker e kam njohur në... - deshi të shpjegonte Uinterborni.

- E di ku e keni njohur. E keni njohur në Gjenevë. Më tregoi ajo. Mua më njohët në Vevey. E njëjta gjë. Kështu mund të vinit tek unë.

Nuk shtoi më asgjë rreth kësaj, sepse filloi të llomotisë për punët e veta.

- Në hotel kemi dhoma të mrekullueshme. Eugjenio thotë se janë dhomat më të mira në Romë. Do të qëndrojmë gjithë dimrin, nëse nuk do të vdesim nga ndonjë ethe. Pra, po të jemi gjallë, do të qëndrojmë këtu. Është më bukur se sa mund ta mendoja, pasi kujtova se qe ndonjë vend thjesht modest dhe do të mërzitesha. Mendoja se do të vinim rrotull gjithë kohën me ndonjërin prej atyre pleqve të tmerrshëm që shpjegojnë pikturat ose gjërat e tjera. Kemi vetëm një javë këtu dhe jam shumë e kënaqur. Njoh shumë njerëz dhe të gjithë janë kaq magjepsës. Një shoqëri plotësisht e zgjedhur. Nga të gjitha llojet: anglezë, gjermanë dhe italianë. Them se më pëlqejnë anglezët më shumë. Pëlqej mënyrën se si bisedojnë. Ka edhe disa amerikanë të këndshëm. Nuk kam parë kurrë shoqëri më të hapur. Çdo ditë ndodh diçka e re. Nuk kërcehet shumë, por më duhet të them se nuk kam menduar ndonjëherë që kërcimi është gjithçka. Gjithmonë kam qenë e dhënë pas bisedave. Nuk do të ngopem së foluri te zonja Uoker, në ato dhoma aq të vogla.

Kur kaluan portën e parkut të Pincios, zonjusha Miler deshi të dijë se ku qe zoti Xhovaneli.

- Më mirë të shkojmë drejt e përballë, - tha ajo. - E shikoni?

- Sigurisht, nuk do t'ju ndihmoj që ta gjeni, - tha Uinterborni.

Ajo shpërtheu në gaz.

- Keni frikë se do të humbisni? Apo se do t'ju kalojë gjë sipër? Po ja, ja ku është Xhovaneli, mbështetur te ajo pema. Ua ka ngulur sytë grave ndër karroca: a keni parë njeri që nuk i shfaq emocionet si ky?

Uinterborni pa atje tej një burrë trupshkurtër, me krahë të kryqëzuar, që kujdesej për bastunin e vet. Qe i pashëm, kishte një kapelë të vënë me shumë shije, një monokël dhe një buketë në thilenë e xhaketës. Uinterborni e pa një çast dhe tha:

- Mendoni t'i flisni atij njeriu?!

- A mendoj t'i flas? Ju mendoni se duhet të flas me të me shenja?

- Ju lutem, atëherë, kuptomëni që unë dua të rri me ju.

Deizi qëndroi dhe e pa, pa asnjë gjurmë turbullimi në fytyrën ku shquheshin sytë e bukur dhe qukat e faqeve. "Është kaq e vetëpërmbajtur", - mendoi djaloshi.

- Nuk më pëlqeu mënyra se si folët, - tha Deizi. - Është arrogante.

- Kërkoj falje dhe tërhiqem. Çështja është t'ju jap një ide për atë që dua të them.

Ajo e pa edhe më egër, por me sytë më të bukur se kurrë.

- Nuk kam lejuar kurrë që të më tregojnë se çfarë të bëj, apo të më ndërhyjnë në gjërat që bëj.

- Mendoj se keni gabuar, - tha Uinterborni. - Ndonjëherë duhet t'ia vini veshin ndonjë zotërie, ndonjërit për të qenë.

Deizi ia krisi gazit.

- Unë nuk bëj gjë tjetër, veçse dëgjoj zotërinjtë, thirri ajo. - Por më thoni pak: zoti Xhovaneli a është një zotëri për të qenë?

Zotëria me lulen në thilenë e xhaketës i kishte parë dy miqtë tanë dhe iu qas vajzës me një ngut prej shërbëtori të bindur. Ai u përkul para Uinterbornit, si edhe para shoqërueses së tij: kishte buzëqeshje të shkëlqyer dhe shikim intelgjent, prandaj Uinterborni nuk pat ndonjë mendim të keq për të. Megjithatë, vajzës i tha:

- Jo, nuk është.

Deizi kishte dhunti të lindur për të bërë prezantime: shqiptoi emrin e secilit nga miqtë e saj. Vetë zuri vend midis të dyve dhe zoti Xhovaneli, që fliste mirë anglisht - Uinterborni do të mësonte se ai e kishte praktikuar atë me shumë trashëgimtare të pasura amerikane i lëshoi plot gjepura të njerëzishme. Ai ishte shumë i rafinuar dhe djaloshi amerikan, që nuk foli fare, po mendonte mbi atë thelksi të zgjuarsisë italiane, e cila i lejon ata të duken më të mirësjellshërn, sa më të zhgënjyer të jenë. Sigurisht, Xhovaneli kishte logaritur diçka më intime dhe nuk e priste këtë treshe, por e mbante veten në një mënyrë që tregonte qëllime të mëpasshme. Uinterborni ia bënte qejfin vetes, për aftësinë që kishte treguar në njohjen e atij njeriu. :Nuk është zotëri, mendoi. Është vetëm kopje e një të tilli". Do të jetë ndonjë mësues muzike, shkarravitës pa vlerë ose një artist i dorës së tretë. Në djall, pamja e tij e bukur!" Padyshim, zoti Xhovaneli qe bukurosh, por Uinterborni u zemërua me bashkatdhetaren e bukur që nuk dinte të bënte dallimin midis një zotërie të rremë dhe një zotërie të vërtetë. Xhovaneli bëri plot dërdëllitje lojcake, duke u treguar shumë i këndshëm: nëse ishte një imitim, bëhej fjalë për një imitim të përkryer. "Sidoqoftë, - mendoi Uinterborni, - një vajzë për të qenë, duhej ta kuptonte!" Tashti shtrohej çështja nëse ajo ishte një vajzë për të qenë. A duhej një vajzë për të qenë, qoftë kjo dhe një flirtuese e vogël amerikane, të linte takim me një të huaj, me sa dukej, pa shumë karakter? Në këtë rast, në të vërtetë, takimi qe në mes të ditës dhe në cepin më të populluar të Romës: po a nuk do të shihej kjo si një shenjë e

tepëruar cinizmi? Sado e pazakonshme që dukej, Uinterborni qe nxehur me vajzën, e cila, pasi gjeti amoroson e saj, nuk bezdisej nga shoqëria e tij, por qe nxehur dhe me veten që nuk largohej dot. Ishte e pamundshme edhe ta quaje një zonjushë me sjellje të saktë, sepse i mungonte delikatesa e nevojshme. Gjithçka do të bëhej më e thjeshtë, nëse do të mund ta trajtonte si objekt i atyre ndjenjave që romancierët i quajnë "pasione erotike jashtë martese". Nëse ajo donte ta hiqte qafe, kjo do ta ndihmonte ta shihte më lehtësisht dhe kështu do t'i dukej më pak e ndërlikuar. Por Deizi vazhdonte të shfaqej si një përzierje e ngatërruar e kokëkrisjes dhe pafajësisë.

Ajo kishte ecur rreth një çerek ore në shoqërinë e dy kavalierëve, duke i pritur me tonin e një lumturie fëminore, siç iu duk Uinterbornit, fjalët tërheqëse të zotit Xhovaneli, kur një karrocë e shkëputur nga radha pafund e tyre, u qëndroi pranë. Uinterborni pa se zonja Uoker, zonja e shtëpisë nga kishin dalë pak më parë, po i bënte me shenjë që nga karroca. Ai u shkëput nga zonjusha Miler dhe nxitoi t'i bindej thirrjes së saj. Zonja Uoker qe krejt e skuqur dhe tejet e ngarkuar nga emocionet.

- Është e tmerrshme, - tha. - Vajza nuk duhet të bëjë nga këto gjëra. Nuk është mirë të shëtisë kështu me ju të dy. E kanë parë kaq shumë njerëz. Uinterborni ngriti vetullat përpjetë.

- Mendoj se nuk është mirë të bëhet kështu për të, - tha Uinterborni.

- Mendoj se duhet ta pengojmë shkatërrimin që ajo po i bën vetes.

- Ajo është shumë e çibltër, - tha Uinterborni.

- Është tmerrësisht e çmendur, thirri zonja Uoker. – A keni parë ndonjëherë diçka më budallaqe se nëna e saj? Pasi u ndanë, unë mendova gjithë kohën për këtë vajzë. Është për të ardhur keq, nuk di as

të ruajë veten. Vura kapelën, mora një karrocë dhe erdha këtu, aq shpejt sa munda. Falënderoj Zotin që ju gjeta.

- E çfarë mendoni se duhet të bëjmë? - pyeti Uinterborni, duke buzëqeshur.

- Ta marr në karrocë, ta shëtis për nja një gjysmë ore këtu përreth, që ta marrë vesh bota se nuk është krejt jashtë kontrollit, pastaj ta çoj në hotel.

- Nuk mendoj se është ajo që duhet, - tha Uinterborni, megjithatë, përpiquni një herë.

Zonja Uoker i eci para. Djaloshi shkoi pas zonjushës Miler, e cila, pasi përshëndeti me një buzëqeshje zonjën Uoker, kishte bërë më tej me shoqëruesin e saj. Kur mori vesh se donte t'i fliste zonja Uoker, Deizi u kthye, duke mbajtur zotin Xhovaneli në krah. Tha se ishte e lumtur që kishte rastin t'ia prezantonte atë zotëri zonjës Uoker. E bëri prezantimin shumë shpejt dhe shtoi se nuk kishte parë gjë më të bukur se kuverta që përdorte zonja Uoker për të mbuluar këmbët aty brenda në karrocë.

- Gëzohem, për këtë që thoni, ia ktheu zonja Uoker, duke buzëqeshur ërnbël. - A do të hyni dhe ta mbani atë një copë rrugë?

- Jo, faleminderit, tha Deizi. Parapëlqej ta shoh te ju.

- Ejani brenda dhe të shëtisim pak, - tha zonja Uoker.

- Do të ishte gjë e bukur, por është më bukur këtu ku jam.

Deizi hodhi një vështrim domethënës tek dy zotërinjtë krah saj.

- Mund të jetë gjë e bukur, e vogla ime, por nuk ësht zakon në këto anë, tha zonja Uoker, duke u përkulur pak me duart e bashkuara si për lutje.

- Duhet bërë ky zakon, - tha Deizi, nëse nuk shëtis, unë marr fund.

- Ju duhet të shëtisni me nënën tuaj, e dashura ime, - thirri zonja nga. Gjeneva, duke humbur durimin.

- Me nënën time! - shpërtheu vajza.

Uinterborni pa se vajza e ndjeu këtë si ndërhyrje në punën e saj.

- Nëna ime nuk i ka bërë kurrë dhjetë hapa në jetën e saj, - shtoi vajza. - Pastaj, e dini, i kam mbushur pesë vjeç prej kohësh.

- Keni aq moshë sa për të pasur arsyen. E dashura Deizi Miler, jeni aq e madhe sa për t'u bërë temë bisedash.

Deizi e pa zonjën Uoker me një buzëqeshje gjithnjë e më të dukshme.

- Çfarë doni të thoni me temë bisedash?

- Ejani në karrocë që t'jua them.

Deizi hodhi vështrime të shpejta sa nga njëri zotëri tek tjetri. Zoti Xhovaneli përkulej kohë pas kohe, duke fërkuar dorashkat me një buzagaz gjithë hir, ndërsa Uinterborni mendoi se kishte mbërritur një skenë jo fort e kënaqshme.

- Nuk besoj se dua të di çfarë doni të thoni me këto, - tha Deizi, pas pak. - Nuk mendoj se do ta pëlqeja atë.

Uinterborni deshi që zonja Uoker të ikte tutje me gjithë karrocën e saj, por, siç i tha atij më vonë, nuk i pëlqente ta fyenin.

- Do t'ju pëlqente t'ju quanin një zonjushë që nuk e njeh frikën? - pyeti ajo.

- Zoti më faltë! - thirri Deizi.

Dhe pa, së pari, nga zoti Xhovaneli e mandej nga Uinterborni.

Kishte pak të kuq në mollëza dhe dukej shumë e bukur.

- A mendon zoti Uinterborn, - tha ngadalë, buzagaz, duke i dhënë kokës prapa dhe duke e parë atë nga koka te këmbët, që, për të ruajtur nderin tim, duhet të futem në karrocë?

Uinterborni u skuq dhe ngurroi të fliste. Ishte e çuditshme ta dëgjoje se si fliste ajo për "nderin" e saj, por i duhej të fliste me ndershmërinë e xhentëlmenit. Sjellja më e mirë tashti ishte thjesht t'i tregonte asaj të vërtetën: kjo, sipas shenjave që kam arritur të jap te

lexuesi, ishte dëgjimi i këshillës së zonjës Uoker. I hodhi një vështrim bukurisë së saj të brishtë dhe i tha me ëmbëlsi:

- Mendoj se duhet të shkoni në karrocë.

Deizi ia dha një të qeshure të fortë.

- Kurrë nuk kam dëgjuar diçka më pa fantazi. Nëse po bëj diçka të pavend, atëherë unë nuk kam vend këtu, kështu që më duhet të ngrihem. Mirupafshim! Shpresoj të keni një shëtitje të këndshme!

Pas kësaj, së bashku me zotin Xhovaneli, i cili bëri një përshëndetje tepër lajkatare, u larguan. Zonja Uoker e ndoqi me ca sy plot lot.

- Futuni brenda, - i tha Uinterbornit, duke i treguar një vend pranë vetes.

Djaloshi i tha se e ndiente për detyrë të shoqëronte zonjushën Miler, mirëpo ajo ia ktheu që, nëse do ta kundërshtonte, nuk do t'i fliste më kurrë. Ishte tepër serioze në atë që tha. Uinterborni arriti Deizin dhe shoqëruesin e saj dhe, pasi i dha dorën asaj, i tha se zonja i kërkonte të shkonte me të. Priti që ajo të tregohej e sertë, diçka që do ta ngatërronte në atë rrugën e "guximit", nga e cila qe përpjekur aq shumë ta shmangte zonja Uoker. Por ajo i dha dorën, duke e parë fare pak, ndërsa. zoti Xhovaneli i tha "rnirupafshim" me një lëvizje të tepruar të kapelës.

Uinterborni nuk ishte në humorin më të mirë të mundshëm, kur u ul në karrocën e zonjës Uoker.

- Nuk ishte diçka e zgjuar nga ana juaj, - i tha hapur, ndërsa karroca futej në rresht me të tjerat.

- Në këto raste, - ia ktheu bashkëbiseduesja, - nuk më intereson zgjuarsia, por ndershmëria e sinqeriteti!

- Ndershmëria juaj vetëm sa e ofendoi dhe e largoi.

- Gjithsesi, u bë më e mira, tha zonja Uoker. – Nëse do t'i zgjasë dëshira për t'u ekspozuar, sa më parë ta dimë, aq më mirë është. Kështu që do të bëhet diçka në kohë.

- Nuk mendoj se ka diçka të keqe në mendje, ia ktheu Uinterborni.

- Kështu kam menduar edhe unë një muaj më parë, por shihni se ku përfundoi puna.

- Çfarë do të thuash?

- Doli kundër çdo parashikimi. Flirtonte me çdo burrë që i dilte përpara, rrinte qosheve me italianë të dyshimtë, kërcente gjithë mbrërnjen me të njëjtit partnerë dhe priste vizita në njëmbëdhjetë të natës. Në këto vizita e ëma largohej.

- Ndërsa i vëllai rri zgjuar deri në mesnatë, - qeshi Uinterbomi.

- Të bukur edukatë që merr ai fëmijë midis këtyre gjërave! Në hotel vajzën e marrin të gjithë nëpër gojë: i gjithë personeli zgërdhihet, kur ndonjë burrë vjen e pyet për të.

- S'e vras mendjen për personelin! - tha Uinterborni i nxehur. Dhe shtoi: - I vetmi faj i së shkretës vjen, ngaqë është e pakultivuar.

- Mungesën e taktit e ka nga natyra, - tha zonja Uoker. - Merrni shembullin e sotëm. Sa kohë e njohët në Vevey?

- Një dyditësh.

- Me tekat e saj, ikjen tuaj e ktheu në një çështje personale!

Uinterborni heshti për një çast, pastaj tha:

- Kam frikë se unë e ti kemi ndenjur shumë gjatë në Gjenevë!

Ndërkohë, i kërkoi t'i thoshte qëllimin për të cilin e kishte marrë në karrocë.

- T'ju lutem t'i ndërprisni marrëdhëniet me zonjushën Miler… të mos dilni me të... të mos ia jepni mundësinë e ekspozimit... shkurt, ta lini të qetë.

- Kam frikë se nuk mund ta bëj, - tha Uinterborni. - Më pëlqen shumë.

- Një arsye më shumë që të mos e shtyni drejt skandalit.

- Fjalët e mia për të, nuk bien asnjë erë skandali.

- Varet se si i merr ajo. Sidoqoftë, thashë ç'kisha për të thënë. Nëse doni të bashkoheni me të, mund ta ndaloj karrocën që tashti. E keni shansin. Karroca po përshkonte atë pjesë të parkut të Pincios, e cila del mbi murin e Romës dhe shikon nga e mrekullueshmja Villa Borghese. Ajo shtrihet pranë një parmaku të madh prej guri, ku ndodhen disa stola. Njëri prej stolave atje tej qe zënë nga një zotëri dhe një zonjë, të cilëve zonja Uoker u dha një tundje koke. Në këtë çast, dy personat u ngritën dhe u nisën drejt parmakut të gurtë. Uinterborni i kërkoi karrocierit të ndalonte dhe zbriti nga karroca. Zonja Uoker e pa një çast në heshtje, pastaj, kur ai ngriti kapelën, u nis gjithë madhështi. Uinterborni qëndroi aty, duke kërkuar me sy Deizin dhe kavalierin e saj.

Ata vetë nuk shihnin njeri, ashtu siç ishin shumë të përkushtuar ndaj njëri-tjetrit. Kur arritën te muri i ulët i parkut, qëndruan duke parë pishat e mëdha te Villa Borghese dhe Xhovaneli u ul pa ceremoni mbi të ndarën e madhe të murit. Andej nga perëndimi, dielli nxori një heshtë të ndritshme nëpër një grumbull resh dhe shoqëruesi i Deizit ia mori asaj çadrën nga dora dhe e hapi. Ajo u avit dhe u fut nën çadër, të cilën Xhovaneli e uli te supi, prandaj Uinterborni nuk mund t'i shihte dy kokat e tyre.

I riu qëndroi një çast, pastaj filloi të ecte. Nuk shkonte drejt çiftit me çadër, por drejt apartamentit të tezes së vet, zonjës Kostello.

IV

Një ditë më pas, Uinterborni e ndjeu veten mirë që nuk pat asnjë të zgërdhirë ndër punonjësit e hoteli, kur ai kërkoi zonjën Miler në hotel. Sidoqoftë, zonja dhe e bija nuk qenë në dhomë, as atë ditë, as ditën tjetër. Mbrëmja tjetër në shtëpinë e zonjës Uoker qe pas tre ditësh dhe, megjithëse qenë ndarë ftohtë herën e fundit me zonjën e shtëpisë, Uinterborni u gjend mes mysafirëve. Zonja Uoker ishtc një nga ato amerikane që, ndërsa janë jashtë atdheut, synojnë, sipas shprehjes së tyre vet, të studiojnë shoqërinë evropiane dhe, me këtë rast, kishte mbledhur disa specie të llojeve të ndryshme që do t'i shërbenin si libra mësimi. Kur mbërriti Uinterborni, Deizi Mileri nuk ishte aty, por pak çaste më vonë, pa të vinte e nëna e saj, vetëm, e skuqur dhe me pamje si për të kërkuar ndjesë. Flokët e saj qenë më kaçurrelë se çdo herë tjetër. Kur ajo u ndodh pranë zonjës Uoker, u shkoi pranë edhe Uinterborni.

- Siç e shihni, kam ardhur vetëm, - tha e shkreta zonja Miler. - Jam kaq e trembur, por nuk e di ç'të bëj, pasi është hera e parë që shkoj vetëm në një mbrëmje, sidomos në këtë vend. Desha të merria Randolfin ose Eugienion, cilido të ishte, por Deizi më nisi vetëm. Por unë nuk jam mësuar të shkoj vetëm nëpër këto vende.

- Nuk do të na nderojë vajza juaj me praninë e saj? - pyeti në mënyrën më mbresëlënëse zonja Uoker.

- Oh, Deizi është veshur e tëra, - tha zonja Miler, me tonin e historianit të ftohtë, në mos filozofik, me të cilin fliste për ngjarjet e fundit të karrierës së vajzës së saj. - Ishte veshur qëllimisht që para darke, por ka një mik nga të sajët aty, atë zotërinë, italianin, që dëshiron ta sjellë këtu. Janë te pianoja dhe duket sikur nuk mund të ndalojnë kurrë. Zoti Xhovaneli këndon aq bukur. Por besoj se nuk do të vonojnë shurnë, - përfundoi gjithë shpresë zonja Miler.

- Oh, më vjen keq që i paska ndodhur kështu, - tha zonja Uoker.

- I thashë se nuk kishte pse të vishej tri orë para darkës, nëse do t'i duhej të priste kaq shumë, - vazhdoi nëna e Deizit. - Nuk e shoh me vend që të vishej ashtu, teksa rri atje me zotin Xhovaneli.

- Kjo është më e tmerrshmja! - i tha zonja Uoker Uinterbornit, pak mënjanë. - *Elle s'affiche*[7]. Kjo është hakmarrja e saj për vërejtjet që ia shpreha. Kur të vijë, nuk do t'i flas fare.

Deizi erdhi pas orës njëmbëdhjetë, por nuk u tregua, siç ndodh në këto raste, një vajzë re që pret t'i flasin. Bëri përpara me hir rrezëllitës, buzagaz dhe fialëshumë, me një *buketë* të madhe dhe e shoqëruar nga zoti Xhovaneli. Të gjithë e lanë bisedën dhe u kthyen ta shihnin, ndërsa ajo shkoi drejt e te zonja Uoker.

- Kisha frikë se, mendonit që nuk do të vija, prandaj dërgova nënën për t'ju vënë në dijeni. Doja që zoti Xbovaneli të bënte disa prova, përpara se të vinim: besoj, e dini se ai këndon shumë bukur dhe

[7] *Elle s'affiche – Kërkon të bjerë në sy (frëngj.)*

do të doja t'i kërkonit të kndonte për ju. Ky është zoti Xhovaneli, e njihni apo jo, jua kam prezantuar: ka zë mjaft të ëmbël dhe di të këndojë këngë të mrekullueshme. E bëra me qëllim të këndonte këtë mbrëmje dhe kaluam çaste të paharrueshme në hotel. Deizi e çliroi veten nga të gjitha këto, duke i thënë në mënyrën më të ëmbël dhe më të qartë të mundshme, duke vështruar herë të zonjën e shtëpisë, herë përqark dhomës, teksa paloste me dorë supet dhe kindat e fustanit.

- Kam ndonjë të njohur këtu? - pyeti ajo.

- Mendoj se ju njohin të gjithë, - tha e bindur zonja Uoker dhe përshë deti kalimthi zotin Xhovaneli.

Ky zotëri u tregua mjaft fisnik. Përshëndeti buzagaz, me dhëmbët e bardhë , përdrodhi mustaqet, vërtiti sytë andej-këndej, duke përmbushur të gjitha funksionet e një bukuroshi italian, në një mbrëmje feste. Këndoi mrekullisht disa këngë, megjithëse, më vonë, zonja Uoker pohoi që s'ishte në gjendje të thoshte se kush ia kishte kërkuar të këndonte. Dukej se nuk ishte Deizi që ia kishte kërkuar këtë: ajo qe ulur larg pianos dhe, megjithëse e kishte pranuar publikisht se i admironte këngët e tij, fliste me zë të lartë ndërsa ai këndonte.

- Sa keq që dhomat janë kaq të vogla dhe s'mund të vallëzojmë, - i tha ajo Uinterbornit, si ta kishte parë para pesë minutave.

- S'më vjen keq që s'mund të kërcejmë, - u përgjigj Uinterborni. - Unë nuk di të kërcej.

- Sigurisht, s'doni të kërceni, pasi jeni shumë i sertë, - tha Deizi. - Shpresoj të jeni kënaqur në udhëtimin me zonjën Uoker.

- Aspak, do të parapëlqeja të lëvizja me ju.

- U bëmë dy çifte dhe kjo qe mrekullia vetë, - tha Deizi. - A keni dëgjuar ndonjëherë ndonjë kërkesë aq të çuditshme sa ajo e zonjës Uoker: të hyj në karrocën e saj dhe të lë të shkretin Xhovaneli, gjoja se kjo ishte ajo që duhej bërë! Njerëzit janë të çuditshëm! Mendoj se do të

ishte shumë e rëndë për zotin Xhovaneli, pasi kishte dhjetë ditë që më kishte folur për këtë shëtitje.

- Ai nuk duhej t'ju kishte folur fare për të, - tha Uinterborni. - Nuk do t'i porpozonte kurrë një zonjusheje të këtij vendi që të shëtiste rrugëve me të.

- Rrugëve? - thirri Deizi, duke ia mbërthyer sytë e bukur. - Po ku duhej, atëherë? Për më tepër, Pincio nuk është rrugë dhe, falë zotit, nuk jam prej këtij vendi. Siç kam dëgjuar, zonjushat e këtushme jetojnë si të burgosura dhe nuk e di pse duhet të ndryshoj sjelljet e mia për to.

- Kam frikë se sjelljet e tua janë ato të një vajze që pëlqen të flirtojë, - tha hapur Uinterborni.

- Sigurisht, - tha ajo, duke i dhënë përsëri një buzëqeshje të vogël. - Më pëlqen jashtëzakonisht të flirtoj. A keni dëgjuar të mos i pëlqejë kjo një vajze të bukur? Apo mos doni të thoni se unë nuk jam një vajzë e bukur?

- Sigurisht që jeni, shumë madje, por unë do të doja të flirtonit me mua dhe vetëm me mua, - tha Uinterborni.

- Oh, faleminderit, faleminderit shumë, por ju jeni burri i fundit me të cilin do t'më shkonte në mend të flirtoja. Siç pata kënaqësinë t'ju bëja me dije edhe më parë, ju jeni mjaft i ftohtë.

- Po e thoni aq shpesh, - tha Uinterborni.

Deizi ia dha një të qeshure.

- Do t'jua thosha sërish, po ta dija se do të zemëroheshit.

- Mos e bëni më, sepse kur zemërohem unë, nuk ma del njeri. Nëse nuk doni të flirtoni me mua, të paktën ndërpriteni flirtin me atë mikun tuaj te pianoja: nuk i kuptojnë këto lloj gjërash këtu.

- Unë po mendoja se ata nuk kuptojnë asgjë tjetër, - thirri Deizi.

- Jo me zonjusha të pamartuara.

- Më duket më me vend me të pamartuara, sesa me të martuara, - tha Deizi.

- Veçse, - tha Uinterborni, - gjërat bëhen sipas vendit. Flirti nuk ekziston këtu: ai është zakon pastërtisht amerikan. Kështu, kur të bëni dalje publike me zotin Xhovaneli, pa pasur nënën në krah…

- O Zot! Mëshiroje nënën time të shkretë! - ndërhyri Deizi.

- Megjithëse ju po flirtoni, zoti Xhovaneli nuk po bën të njëjtën gjë, pasi ka ndërmend një gjë tjetër nga kjo.

- Të paktën, ai nuk është njeri që jep këshilla kohë pa kohë, - ia ktheu Deizi gjithë gjallëri.

- Nëse interesoheni ta dini, nuk po flirton asnjëri nga ne, pasi jemi vetëm miq të mirë, shumë të afërt me njëri-tjetrin.

- Ah! - ia bëri Uinterborni. - Nëse jeni të dashuruar, është një çështje tjetër.

Ajo po e linte të fliste krejt hapur, prandaj nuk e priti befasinë e saj prej fjalëve të fundit, sepse Deizi u ngrit menjëherë, e kuqe flakë, duke e bërë atë të mendojë se flirtueset e reja amerikane qenkan krijesat më të çuditshme në botë.

- Së paku, - tha ajo, duke i hedhur bashkëbiseduesit një shikim të vetëm, - zoti Xhovaneli nuk më thotë kurrë nga këto.

Uinterborni, i turbulluar, kishte mbetur syçakërritur. Zoti Xhovaneli sapo kishte mbaruar së kënduari dhe iu afrua Deizit pranë.

- Pse nuk vini në dhomën tjetër e të pimë një çaj? - pyeti ai, duke u përkulur para saj me buzëqeshjen e sajuar bukur.

Deizi u kthye nga Uinterborni, duke iu kthyer buzëqeshja pak nga pak. Ai u ngatërrua edhe më shumë nga kjo buzëqeshje, të cilën nuk po e kuptonte, megjithëse dukej se ajo provonte që po i kthehej ëmbëlsia dhe butësia e faljes së ofendimit.

- Nuk ka ndodhur kurrë që të më ofrojë ndonjë çaj zoti Uinterborn, - tha ajo në mënyrë shumë ngacmuese.

- Ju kam ofruar këshilla, - ia ktheu Uinterborni.

- Parapëlqej më tepër një çaj të lehtë, - tha Deizi dhe doli me të shkëlqyerin Xhovaneli.

U ul me të pranë dritares në dhomën matanë, ku ndenjën pjesën tjetër të mbrëmjes. Ndërkohë dikush po luante shkëlqyeshëm në piano, po asnjëri prej tyre nuk i kushtoi vërnendje. Kur Deizi erdhi të ndahej, zonja Uoker arriti të mposhtte dobësinë e treguar në çastin e ardhjes së vajzës: i ktheu shpinën dhe e la të ikë. Uinterborni, që qëndronte pranë derës, pa gjithçka. Deizi u zbeh dhe pa nga e ëma, por zonja Miler nuk kapi asnjë shkelje të normave të zakonshme të shoqërisë. Në të vërtetë, u duk sikur tregoi shtysën e papërshtatshme për të tërhequr vëmendjen siç duhej.

- Natën e mirë, Zonja Uoker! - tha. - Kaluam një mbrëmje të mrekullueshme. Nëse e lë Deizin të vijë pa mua, nuk dua ta lë të ikë vetëm.

Deizi u largua, duke parë me një pamje të zbehtë e serioze njerëzit pranë derës, por Uinterborni e kuptoi se ajo qe tepër e tronditur dhe e turbulluar prej asaj që i kishin bërë. Qe prekur edhe ai vetë.

- E tejkaluat cakun, - i tha zonjës Uoker.

- Nuk do të shkelë kurrë më këtu, - ia ktheu e zonja e shtëpisë.

Pas kësaj përgjigjeje të zonjës Uoker, Uinterbornit iu desh të shkojë sa më shpesh që të mudej te hoteli i zonjës Miler. Gratë gjendeshin shumë rrallë aty, por edhe kur gjendeshin, Xhovaneli i përkushtuar, qe gjithmonë e pranishëm. Shumë shpesh romani i imtë e gjithë rnirësjellje, ndodhej në dhomë vetëm për vetëm me Deizin: dukej se zonja Miler mendonte që, mosndërhyrja, qe më e mira mbikëqyrje. Uinterborni e kuptoi, fillimisht me habi, që Deizi nuk zemërohej kurrë me ardhjet e tij, por, më pas, pa se ajo nuk ruante të papritura për të: e papritura qe gjëja e fundit që mund të prisje nga ajo. Ajo nuk tregonte pakënaqësi që ndërhynin ndërmjet *tête-à-tête* me Xhovanelin, sepse mund të fliste njëfioj me dy zotërinj njëherësh: në bisedat e saj

qëndronte e njëjta përzierje, mes kokëkrisjes dhe dëlirësisë. Uinterborni arriti në përfundimin se, nëse ajo interesohej seriozisht për Xhovanelin, pse nuk bënte më shumë për të ruajtur shenjtërinë e bisedave të tyre, prandaj e pëlqente më shumë për moskokëçarjen e pafajshme dhe gjendjen e veçantë shpirtërore. Nuk dinte ta thoshte arsyen, por ajo i dukej një vajzë që nuk do të bëhej kurrë xheloze. Duke marrë parasysh rrezikun e ndonjë buzëqeshjeje ironike nga ana e lexuesit, mund të pohoj se, për gratë që qe i interesuar, shpesh, në rrethana të caktuara, do të duhej t'i kishte frikë: pikërisht frikë. Pati kënaqësinë të mendonte se nuk do të frikësohej kurrë nga Deizi Miler. Kjo nuk vinte e gjitha prej Deizit: qe pjesë e bindjes së tij ose, më fort, e të kuptuarit që, në fund të fundit, ajo do të provonte se qe një vajzuke e lehtë.

Megjithatë binte në sy interesimi i saj për Xhovanelin: e shikonte kur ai i fliste, i thoshte vazhdimisht që të bënte këtë apo atë, "e vinte në lojë" dhe bënte shaka të çfarëdolloj. Ndërkohë, dukej se e kishte harruar plotësisht që Uinterborni i pat thënë diçka dëshpëruese te shtëpia e zonjës Uoker. Një të diel pasdite, kur pat shkuar te Kisha e Shën Pjetrit me tezen, Uinterborni e pa Deizin duke u endur brenda kishës, e shoqëruar, si gjithmonë nga Xhovaneli. Ia tregoi tezes atë dhe kavalierin e saj. Zonja e vjetër pa një copë herë me monokël dhe pastaj tha:

- Kjo është ajo që ju ka bërë kaq të menduar, ë?

- Nuk e kisha vënë re se paskam qenë i menduar, - ia ktheu djaloshi.

- Je shumë i shpërqendruar, sepse mendon vazhdimisht për diçka.

- Ç'të jetë kjo për të cilën më akuzoni? - pyeti ai.

- Kjo zonjusha Baker, Chandler a Miler, si e quajnë. Të fshehtat e saj dashurore me atë tipin e pispillosur.

- E quani të fshehtë, - pyeti ai, - diçka që është kaq haptas, në dritën e diellit?

- Kjo është marrëzia e jo përparësia e tyre, - ia ktheu zonja Kostello.

- Jo, - tha Uinterborni me diçka nga ajo pamja e menduar, ku e pat hedhur fjalën tezja e tij. - Nuk besoj se kjo mund të quhet e fshehtë.

- Kam dëgjuar shumë veta të flasin për të. E ka humbur krejt kontrollin e vetes.

- Sigurisht, janë shumë të afërt, - tha Uinterborni.

Zonja Kostello i shikoi edhe një herë dy të rinjtë, me mjetin optik.

- Është shumë i pashëm. Kushdo mund ta kuptojë se si qëndron puna. Ajo e sheh atë si burrin më elegant në botë, si zotërinë më të hijshëm. Nuk ka parë kurrë një të tillë, pasi ai është edhe më i mirë se shoqëruesi. Ndoshta, shoqëruesi është prezantues dhe, nëse martesa do të ndodhë, ai pret një shpërblim të majmë.

- Nuk besoj se ajo mendon të martohet me të, - tha Uinterborni, - siç nuk besoj se ai shpreson që ajo të martohet me të.

- Mund të siguroheni se ajo nuk mendon asgjë. Kalon nga dita në ditë, nga ora në orë, si në Kohët e Arta. Nuk mund të mendoj diçka më vulgare. Dhe, në të njëjtën kohë, ajo mund t'ju thotë se është "e fejuar".

- Sipas meje, kjo është më tepër nga ç'pret Xhovaneli, - tha Uinterborni.

- Kush është Xhovaneli?

- Ai italiani vocërrak. Kam pyetur për të. Me ç'duket ai është një vocërrak plotësisht i respektueshëm. Besoj se, në një farë mënyre, është *cavaliere avoccato*, por nuk hyn në ato që quhen rrethe të dorës së parë. Mendoj se nuk është e pamundshme që ta ketë prezantuar shoqëruesi. Dhe duket qartë se është shumë i dhënë pas zonjushës. Nëse ajo e sheh

atë si burrin më të hijshëm në botë, ai, nga ana e tij, nuk është ndodhur kurrë kaq pranë luksit e pasurisë, si dhe shpenzimeve që bën. ajo. Kështu që, ajo duhet t'i duket e mrekullueshme dhe interesante. Dyshoj se ai ëndërron të martohet me të, pasi ky fat duhet t'i duket i paarritshëm. Nuk ka asgjë për të ofruar, përveç fytyrës së bukur dhe gjendet një zoti Miler, i fortë dhe i pasur, në atë vendin e mistershëm të dollarëve. Xhovaneli nuk ka asnjë titull për të paraqitur. Të ishte së paku ndonjë kont a markez! Duhet të jetë habitur edhe vetë prej faktit se si e kanë pranuar.

- Ia lë këtë fytyrës së tij të bukur dhe e quan zonjushën Miler *qui se passe ses fantasies*[8], tha zonja Kostelio.

- Është shumë e vërtetë, - vazhdoi Uinterborni, - që Deizi dhe ëma nuk janë ngritur në nivelin, si ta them, të kulturës, ku fillon ideja e kapjes së një konti a markezi. Mendoj se s'kanë atë aftësi mendore për të kapur një gjë të tillë.

- Dhe kavalieri as që e priste këtë fat, - tha zonja Kostello.

Me vëzhgimin e nxitur prej të fshehtave dashurore të Deizit, atë ditë te Kisha e Shën Pjetrit, Uinterborni mblodhi dëshmi jo të pakta. Disa amerikanë, të vendosur ato ditë në Romë, erdhën të bisedonin me zonjën Kostello, e cila qe ulur në një stol të lëvizshëm, pranë bazamentit të një kolone. Vazhdonte një ritual kishtar mes tingujve të mrekullueshëm të organos dhe këngës së korit, ndërsa zonja Kostello e miqtë e saj po flisnin gjithnjë e më shumë për të shkretën Deizi, që "vërtet e pat tepruar". Uinterbornit nuk i pëlqente ajo që dëgjonte, por, kur doli prej kishës dhe pa Deizin të hynte në një karrocë të hapur, së bashku me bashkëfajtorin, duke u sulur rrugëve cinike të Romës, nuk mundi ta mohonte se ajo e kishte tepruar vërtet. I erdhi keq jo ngaqë ajo e kishte humbur mendjen fare, por sepse ishte e dhimbshme të dëgjoje

[8] *Qui se passe ses fantasies – Që është më e mirë se sa mund të imagjinohet (frëngj.)*

gjëra të tilla për të. Pas gjithë kësaj që dëgjoi, ai u përpoq t'ia hidhte fajin zonjës Miler.

Një ditë, takoi në Korso një mik, turist si ai vetë, që sapo kishte dalë nga Palaco Doria, ku pat shëtitur midis galerive të mrekullueshme. Miku i foli një çast për portretin madhështor të papës Inoçenti X, të Velasquez, të varur në një nga sallat e pallatit dhe tha:

- Në të njjtën sallë, meqë ra fiala, pata kënaqësinë të meditoja mbi një pikturë të një lloji tjetër, qe amerikania që më përmendët para një jave.

Duke iu përgjigjur pyetjes së Uinterbornit, ai tregoi se vajza, më e bukur se asnjëherë, qe ulur me dikë në ndarjen e errët pranë portretit të papës.

- Kush qe shoqëruesi? - pyeti Uinterborni.

- Një italian vocërrak me një buketë në thilenë e xhaketës. Vajza është shumë e bukur, por, nëse nuk gaboj, kam kuptuar nga ju që është *du meiller monde*[9]

- Ashtu është! - ia ktheu Uinterborni. Meqë u sigurua se miku i kishte parë Deizin dhe kavalierin e saj vetëm pesë minuta më parë, u hodh në një karrocë dhe u nis t'i bënte një vizitë zonjës Miler. Ajo qe në hotel, por kërkoi të falur që po e priste në mungesë të Deizit.

- Diku ka shkuar me zotin Xhovaneli, - tha. - Gjithmonë vërtitet diku me zotin Xhovaneli.

- Kam vënë re se janë shumë të afërt, - vërejti Uinterborni.

- Oh! Duket sikur nuk mund të jetojnë pa njëri-tjetrin, - tha zonja Miler. - Gjithsesi, ai është një zotëri i vërtetë. I kam thënë Deizit se është e tërhequr shumë pas tij.

- Dhe çfarë thotë Deizi?

---

[9] *Du meilleur monde – E shtresës së lartë (frëngj.)*

- Thotë që jo. Ndoshta edhe është! - shtoi si nënë e paanshrne. - Duket sikur është. Do t'i kërkoj zotit Xhovaneli të ma thotë. Do të doja t'i shkruaja zotit Miler. Si thoni, a duhet ta bëj?

Uiterborni pohoi atë që i kërkoi, ndërsa mënyyra e të menduarit të saj, e panjohur për analet e kronikave prindërore, nuk i dha dorë për t'i tërhequr vëmendjen për Deizin.

Deizi nuk gjendej kurrë në hotel dhe Uinterborni e ndërpreu kërkimin e saj edhe në shtëpitë e miqve të përbashkët, sepse, siç e merrte me mend, ata njerëz mendonin se ajo e kishte tepruar. Këta njerëz nuk e ftonin më Deizin, duke lënë të kuptohej para evropianëve konservatorë se, megjithëse Deizi qe amerikane, nuk i përfaqësonte, madje e quanin sjelljen e saj jonormale. Uinterborni pyeste veten se si ndihej ajo pas gjithë këtyre shpinave të kthyera dhe zemërohej kur dyshonte se nuk ndiente asgjë: e mendonte tepër të lehtë dhe të pafaj, tepër të pamësuar, të palogjikshme, si dhe tepër provinciale, për të gjykuar mbi izolimin që i qe bërë ose për ta perceptuar atë.

Pastaj, mendonte se qenia e saj e brishtë dhe e papërgjegjshrne mbante brenda vetes një vetëdije rebele dhe pasionante, krejtësisht të vëmendshme ndaj asaj që shkaktonte tek të tjera. Pyeste veten nëse kjo sjelljeje e saj vinte nga vetëdija e pafajësisë apo e të qenit, në thelb, një vajzë e re kokëkrisur. Sidoqoftë, përpjekja për të besuar në "pafajësinë" e saj, Uinterbornit filloi t'i dukej si një bujari e strholluar. Siç e thashë edhe më lart, zernërohej që i qe shpartalluar logjika përbarlë asaj vajze: e trazonte mungesa e sigurisë instinktive për atë se në çfarë mase qenë racore, kombëtare apo vetjake, sjelljet e saj. Nga çdo anë t'i qasej, e kishte humbur: ishte tepër vonë. Ajo qe përlarë prej Xhovanelit.

Pak ditë pas bisedës së shkurtër me nënën e saj, ai e takoi Deizin në ndërtesën e mrekullueshme, por të shkretë, të quajtur Pallati i Çezarëve. Fillimpranvera romane e kishte mbushur atmosferën me lule dhe aroma, ndërsa sipërfaqja e ashpër e kodrës Palatino qe veshur me

gjelbërim të butë. Deizi endej sipër njërit nga grumbujt e mëdhenj të rrënojave plot mermerë me myshk e mbishkrime monumentale. Atij iu duk se Roma nuk kishte qenë kurrë më e bukur se sa në atë cast. Rrinte e vështronte harmoninë e magjishme të linjave e ngjyrave që qarkonin qytetin, duke nuhatur aromat e buta, të lagështa dhe duke parë se si, freskia e çastit dhe ajo e lashtësisë, plekseshin në një përzierje të mistershme. Gjithashtu, i dukej se Deizi nuk kishte qenë kurrë aq e bukur mirëpo kjo qe diçka që e provonte sa herë e takonte. Edhe Xhovaneli, që gjendej në krah të saj, rrezatonte një shkëlciim të pazakontë.

- Ma merrte mendja, - thirri Deizi, - që do të ishit i vetëm!

- I vetëm? - pyeti Uinterborni.

- Gjithnjë endeni i vetëm. Nuk gjendet dikush që të ecë me ju?

- Nuk kam atë fat që ka shoqëruesi juaj, - ia ktheu Uinterborni.

Që nga fillimi, Xhovaneli e kishte trajtuar Uinterbornin me mirësjellje të veçantë: e dëgjonte me respekt për çdo rast, qeshte me shakatë e tij, dukej sikur ishte i gatshëm të dëshmonte se Uinterborni qëndronte më lart se ai vetë. Nuk e tregonte veten si dashnor xheloz, sillej me shumë takt dhe nuk tregonte kundërshtim që të poshtërohej lehtë nga ai. Nganjëherë, Uinterbornit i dukej si Xhovaneli do të zbutej aq sa për t'i thënë, si burrë i zgjuar, se, e marrtë e mira, sa e jashtëzakonshme qe kjo vajzë, prandaj nuk do ta përkëdhelte veten me shpresat mashtruese, ose, së paku, tepër mashtruese, për dasmë e dollarë. Mu në këtë çast, Xhovaneli u shkëput që të këpuste një degëz bajameje, të cilën e vendosi me kujdes në thilenë e xhaketës.

- E di pse e thoni këtë, - tha Deizi. - Sepse mendoni që unë bredh si tepër shumë me të.

- Mendojnë të gjithë kështu, nëse ju intereson ta dini, - ia ktheu Uinterborni.

- Sigurisht, më intereson ta di, - tha me seriozitet Deizi. - Por është diçka që nuk e besoj. Vetëm hiqen sikur u bën përshtypje. Në të vërtetë, nuk u intereson ajo çfarë bëj unë. Sidocloftë, nuk shëtis edhe aq shumë.

- Gjithsesi, do ta gjeni vetë se sa interesohen. Dhe do të shfaqen fare të papëlqyeshëm.

Deizi e vështroi për një çast.

- Ç'doni të thoni me të papëlqyeshëm?

- Nuk ju ka rënë në sy asgjë? - pyeti Uinterborni.

- Më keni rënë në sy ju. Kur ju pashë herën e parë, ishit ngrirë si një çadër.

- Keni për të parë se unë nuk jam i ngrirë sa disa të tjerë, - buzëqeshi Uinterborni.

- Cila është mënyra për ta zbuluar?

- Kur të ndesheni me ta.

- Çfarë do të bëjnë?

- Do t'ju kthejnë kurrizin. E dini se çfarë do të thotë kjo?

Deizi, që po e shikonte me seriozitet, filloi të skuqej.

- Siç bëri zonja Uoker atë natë?

- Pikërisht! - ia ktheu Uinterborni.

Deizi vështroi Xhovanelin që po zbukurohej me degëzën e bajames. Pastaj e ktheu vështrimin sërish te Uinterborni.

- Nuk mendoja se do t'i lejonit që të jenë kaq të këqij me mua! - tha ajo.

- Çfarë mund të bëj? - pyeti ai.

- Mendoja se do të thoni diçka.

- Them se... - ai heshti një çast, - them se nëna juaj mendon që jeni të dashuruar.

- Kështu mendon ajo, - tha Deizi me thjeshtësi.

Uinterborni filloi të qeshë.

- A mos mendon kështu edhe Randolfi? - pyeti.

- Them se Randolfi nuk mendon asgjë, - tha Deizi.

Skepticizmi i Randolfit i nxiti Uinterbornit humor të mëtejshëm, por ndërkohë pa se Xhovaneli qe afruar. Afrimin e tij e pa edhe Deizi, e cila iu afrua bashkatdhetarit të vet.

- Meqë ra fiala, - tha ajo, unë jam e dashuruar.

Uinterborni e vështroi dhe ndaloi së qeshuri.

- Jo, ju nuk e besoni, shtoi ajo.

Ai heshti për një çast e pastaj tha:

- E besoj.

- Oh, jo. Nuk e besoni, - vazhdoi ajo. - Atëherë unë nuk jam e dashuruar.

Vajza dhe ciceroni i saj po i drejtoheshin portës së daljes, kështu që Uinterborni, i cili kishte hyrë vonë, u nda prej tyre.

Pas një jave, qe për darkë te një kodër e mrekullueshme mbi Kodrën e Kajit dhe, kur arriti, ktheu karrocën që e solli. Mbrëmja ishte magjepsëse dhe ai nuk ia mohoi vetes kënaqësinë e kthimit në këmbë nën Harkun e Kostandinit, duke kaluar pranë monumenteve dritëpakët të Forumit. Hëna e ngrënë nuk kishte dritë të fortë, por e mbulonte një vello resh, e cila e shpërndante dritën kudo njëlloj. Gjatë kthimit nga vila (ishte ora njëmbëdhjetë), Uinterborni iu afrua harkut të errët të Koloseut, si dashurues i piktoreskes që ishte, sepse ia vlente një shikim nën dritën e hënës. U hoq mënjanë dhe eci te njëri prej harqeve, pranë të cilit pa se qe ndalur një karrocë e hapur, një nga kaloshinat romane. Pastaj kaloi nën hijet e thella të ndërtesës së madhe dhe doli sipër arenës së ndriçuar e të heshtur.

Kurrë nuk i qe dukur më madhështor ai vend. Gjysma e rrethit gjigant ishte në errësirë të thellë, ndërsa gjysma tjetër qe përpirë nga mugëtira e ndriçuar. Ndërsa po rrinte aty, filloi të mërmërisë vargjet e famshme të Manfredit të Bajronit, por para se të mbaronte, u kujtua se,

nëse poetët rekomandojnë meditimet mbrëmësore në Koloseum, mjekët dalin kundër. Sigurisht, jehona historike qe aty, por shkencërisht ajo gjykohej si një çerdhe sëmundjesh. Uinterborni shkoi deri në qendër, për t'i hedhur një vështrim të përgjithshëm, para se të largohej në mënyrë të shpejtë. Kryqin e madh të qendrës e mbulonin hijet dhe, vetëm kur iu afrua, e shqoi qartë. Atëherë pa dy veta që qëndronin në shkallët e ulëta që formonin bazën e tij. Personi i ulur qe grua, ndërsa shoqëruesi i saj rrinte në këmbë, përballë saj.

Pas një copë here, zëri i gruas u bë qartë përmes ajrit të nxehtë të natës.

- Ai po na shikon, siç shikonin dikur luanët e tigrat martirët kristianë!

Fjalët që dëgjoi qenë në theksin e njohur të zonjushës Deizi Miler.

- Të shpresojmë që nuk është shumë i uritur, - ia ktheu me zgjuarsi Xhovaneli. - Së pari, do të merret me mua, kurse ti do t'i shërbesh si ëmbëlsirë.

Uinterborni ndaloi, me një farë tmerri: duhet shtuar se, edhe me një farë lehtësimi. U duk sikur ra një dritë e fortë mbi sjelljen e dyfishtë të Deizit dhe misteri u zbulua i tëri. Ishte një vajzë, të ciiën nuk ia vlente ta respektoje. Ai qëndroi aty, duke parë atë dhe shoqëruesin e saj, pa menduar se ai i shihte vagullt, por ata duhej ta shihnin shumë qartë. U zemërua me veten, që kishte thartuar kokën aq shumë për të krijuar një ide të saktë për zonjushën Deizi Miler. Pastaj, ndërsa po bënte përpara, ndaloi, jo nga frika se po bënte padrejtësi ndaj saj, por prej ndjenjës se rrezikonte të dukej me një pamje të papërshtatshme prej kthesës së beftë nga pozicioni i kritizerit të kujdesshëm. Shkoi drejt daljes, por dëgjoi përsëri zërin e Deizit.

- Po ai ishte zoti Uinterborn! Më pa, por nuk deshi të më flasë.

Ç'horre e vogël dhe e zgjuar që ishte dhe sa bukur e luante pafajësinë e lënduar! Nuk deshi të bëjë sikur nuk e njohu. U kthye dhe shkoi drejt kryqit të madh. Deizi qe ngritur nga vendi, ndërsa Xhovaneli e përshëndeti me kapele. Uinterborni kishte filluar të mendojë se çfarë çmendurie qe, nga ana shëndetësore, për një vajzë të re delikate, të kalonte mbrëmjen në atë çerdhe malarieje. E çfarë se ishte një horre e vogël e zgjuar? Kjo nuk qe një arsye për të vdekur nga malaria.

- Sa kohë keni këtu? - pyeti me një zë pothuajse të ashpër.

Ashtu e bukur nën dritëhënën ledhatare, Deizi e pa një çast. Pastaj u përgjigj njerëzisht:

- Gjithë mbrëmjen. Nuk kam parë kurrë diçka më të bukur.

- Kam frikë se nuk do t'ju duken po kaq të bukura ethet romane, - tha Uinterborni. - Është pikërisht mënyra për t'u sëmurur. U kthye nga Xhovaneli dhe shtoi:

- Habitem se si ju, i lindur roman, lejuat një marrëzi si kjo.

- Ah! ia bëri romani bukurosh. - Unë për vete nuk kam frikë.

- Nuk kam as unë për ju! Po flas për zonjushën.

Xhovaneli ngriti vetullat e përkryera dhe tregoi dhëmbët gjithë shkëlqim, por e pranoi me qetësi kritikën e tjetrit.

- I thashë sinjorinës se qe diçka e pamatur, por a ka marrë vesh ndonjëherë sinjorina?

- Nuk kam qenë kurrë e sëmurë dhe as më shkon mendja të jem, tha sinjorina. - Nuk duket shumë, por unë kam një organizëm të fortë! Dëshiroja shumë që të shihja Koloseun nën dritën e hënës, saqë nuk doja të shkoja në shtëpi pa e parë: dhe kaluam një mbrëmje të mrekullueshme, apo jo Xhovaneli! Nëse ka pasur ndonjë rrezik, Eugjenio do të më japë ndonjë tabletë. Ai ka shumë të tilla.

- Do t'ju këshilloja, - tha Uinterborni, - të niseni në hotel sa më parë që të jetë e mundur dhe ta pini ndonjë prej tyre.

- Është me vlerë ajo që thoni, - tha Xhovaneli. - Unë do të shkoj të siguroj karrocën.

Dhe bëri përpara menjëherë. Deizi dhe Uinterborni e ndoqën. Ky i fundit vazhdonte ta vështronte vajzën: nuk i dukej fare në siklet. Uinterborni nuk foli, kurse Deizi llomotiste për bukurinë e hënës.

- Ja që e pashë Koloseun nën dritën e hënës! - thirri ajo. - Mrekullia vetë!

Pastaj, duke vënë re heshtjen e Uinterbornit, e pyeti atë pse nuk fliste. Ai nuk dha përgjigje: vetëm filloi të qeshte. Ata kaluan nën njërin prej harqeve të erra, ndërsa Xhovaneli u shfaq përballë me karrocën. Në këtë çast, Deizi ndaloi, duke parë nga djaloshi amerikan.

- A besuat që ia kam dhënë fjalën?

- Nuk është problem se çfarë mendova, - ia ktheu Uinterborni, ende duke qeshur.

- Po atëherë, çfarë mendoni?

- Mendoj se nuk ka shumë rëndësi, nëse ia keni dhënë fjalën apo jo!

Nëpër errësirën e lehtë të harkut, ai ndjeu ta mbërthenin sytë e bukur të vajzës: dukej se qe gati për përgjigje, por Xhovaneli u hodh përpara.

- Shpejt, nxito, - tha ai, - nëse do të mbërrijmë në mesnatë, do të jemi më të sigurt.

Deizi zuri vend në karrocë dhe italiani fatlum u ul pranë saj.

- Mos harro tabletat e Eugjenios, - tha Uinterborni, ndërsa po ngrinte kapelën.

- Nuk shqetësohem fare nëse do të më kapin ethet romane, - tha Deizi me një ton të çuditshëm.

Ndërkaq, karrocieri kërciti kamzhikun dhe ata ikën tutje nëpër kaildrëmin e lashtë.

Uinterborni, që të tregohemi të drejtë me të, nuk i tregoi njeriu se kishte takuar Deizin në orët e vona të natës me një zotëri tek Koloseu: sidoqoftë, dy ditë më vonë, kjo ngjarje kishte marrë dhenë në rrethin e amerikanëve të atjeshëm dhe u fol për të gjerësisht. Uinterborni e kuptoi se kjo histori kishte dalë nga hoteli, kur, pas kthimit të Deizit, pat pasur një shkëmbim batutash tallëse mes portierit e karrocierit. Ndërkohë, djaloshi qe i vetëdijshëm se nuk shqetësohej më nga përflitjet që i bënin flirtueses amerikane njerëz jo të ngritur. Një apo dy ditë më vonë, nga këta njerëz mori lajmin tjetër: flirtuesja e vogël amerikane qe tepër e sëmurë. Kur i ra ky thashethem në vesh, Uinterborni shkoi në hotel që të merrte lajme të sakta. Dy-tre miq zemërdhimbshëm kishin ardhur para tij dhe po priteshin në sallonin e zonjës Miler nga Randolfi.

- U sëmur, se shëtiste natën, - tha Randolfi. - Gjithmonë shëtiste natën. S'e kuptoj se ç'donte në një errësirë si kjo. Natën këtu nuk sheh dot, përveçse kur ka hënë. Në Arnerikë ka hënë gjithmonë.

Zonja Miler nuk dukej: ndoshta i rrinte vajzës te koka. Qe e qartë se Deizi qe shumë e sëmurë.

Uinterborni shkonte shpesh, që të mësonte diçka më tepër dhe një herë pa zonjën Miler, e cila, megjithëse shumë e alarmuar, për habinë e tij, e kontrollonte mirë veten, si një infermiere e aftë dhe e kujdesshme. Foli për doktor Dejvisin, por Uinterborni, me vete bëri komplimentin se nuk qe ndonjë patë e frikshme.

- Deizi më foli dje për ju, - tha ajo. - Gjysmën e kohës është në kllapi, por këtë rast u duk shumë në rregull. Më dha një mesazh për ju. Më tha se nuk ka qenë e dashuruar kurrë me atë bukuroshin italian. Jam shumë e kënaqur. Zoti Xhovaneli nuk na ka ardhur që kur ra e sëmurë Deizi. E mendoja zotëri të vërtetë, por nuk kam si e vierësoj këtë sjellje të tij. Një zonjë rnë tha se ndoshta frikësohet se mos unë jam zemëruar, ngaqë e merrte Deizin për shëtitje natën. Ai duhet ta dijë se, në fund të

fundit, unë jam një zonjë për të qenë: nuk do të zemërohesha dot me të. Sidoqoftë, ajo thotë se nuk ishte e lidhur pas tij. Nuk e di pse donte ta dinit, por më tha tri herë: Mos harro t'i thuash zotit Uinterborn! Pastaj më tha t'ju pyesja nëse e kujtoni vizitën që bëtë te ajo kështjella në Zvicër. Por unë i thashë se do ta përcillja këtë mesazh, vetëm nëse ajo nuk ishte e dashuruar pas italianit. Jam shumë e kënaqur që e di se si qëndron puna.

Por, siç ishte shprehur Uinterborni, kjo nuk kishte më rëndësi. Një javë më pas, e gjora vajzë vdiq: kishte qenë një rast i tmerrshëm ethesh. Trupi i saj u preh në një varrezë të vogël protestante, në cep të murit të Romës së lashtë perandorake, poshtë qiparisave dhe luleve pranverore. Uinterborni qëndroi pranë saj, me disa prej pjesëmrrësve në varrim: qe një numër më i madh se ai që pritej, pas skandalit që e ndoqi në të gjallë. Pranë tij ndodhej Xhovaneli, i cili u avit edhe më përpara se Uinterborni të largohej. Ishte shumë i zbehtë, pa lule në thilenë e xhaketës dhe dukej se donte të thoshte diçka.

- Qe vajza më e mrekullueshme që kam parë ndonjëherë. Më zemërmira. - Dhe shtoi në çast: - Më e pafajshmja.

Uinterborni e pa dhe përsëriti fjalët e tij:

- Më e pafajshmja!

Uiterborni u ndie i dëshpëruar dhe gjithë zemërim.

- Pse dreqin e çove te ai vend fatal? - pyeti.

Qetësia e Xhovanelit qe e njëjta. Pa një çast përtokë, pastaj tha:

- Për vetemuk kisha frikë. Ndërsa ajo donte që të shkonim.

- Kjo s'është arsye, - ia ktheu Uinterborni.

Romani finok i uli sytë përsëri.

- Edhe nëse do të jetonte, kjo s'do të kishte rëndësi për mua. Jam i sigurt, nuk do rë martohej kurrë me një si unë.

- Nuk do të martohej kurrë me ju?

- Një herë pata shpresuar. Më vonë e humba çdo shpresë.

Uinterborni dëgjonte me sytë e ngulur në grumbullin e freskët të dheut, të atij varri të ri midis luleshqerrave të prillit. Kur Uinterborni ngriti sytë, Xhovaneli po largohej me hapin e tij të lehtë dhe të ngadaltë. Uinterborni e Romën pothuajse menjalerë, por verën tjetër e takoi përsëri tezen e tij, zonjën Kostello, në Vevey. Zonja Kostello e adhuronte këtë vend. Gjatë gjithë kësaj kohe, Uinterborni kishte menduar shpesh për Deizin dhe sjelijet e saj të pazakonshme. Një ditë, ia hapi bisedën tezes për të, duke i thënë se e vriste ndërgjegjja, që qe treguar i padrejtë me atë vajzë.

- Si mund ta di se sa ka ndikuar padrejtësia jote tek ajo? - tha zonja Kostello.

- Më dërgoi ca fjalë, para se të vdiste, por që, në atë kohë, nuk i kuptova. Tashmë ua di kuptimin. Duket se e merrte në konsideratë respektin e të tjerëve për të. është kjo mënyra modeste për të thënë se ajo mund t'i përgjigjej dashurisë së dikujt?

Uinterborni nuk i dha përgjigje pyetjes, por, pas pak, tha:

- Ishte e drejtë vërejtja që më bëtë verën e kaluar. Ishte e shkruar që të bëja ndonjë marrëzi. Kam jetuar tepër gjatë jashtë.

Sidoqoftë, ai u kthye të jetonte në Gjenevë, prej nga vazhdojnë të vijnë lajme nga më të papajtueshmet për qëndrimin e tij në atë vend: dikush thotë se është zhytur në studime, dikush tjetër aludon se është shumë i dhënë pas një zonje të huaj, shumë të zgjuar.

Henri Xhejms (1843-1916), lindi në Nju Jork. I ati ishte teolog swedenborgian, ndërsa i vëllai, psikologu i mirënjohur William James, i cili e pagëzoi me emrin `Letërsi e përroit të ndërgjegjes" (stream of consciousness literature) atë që shkruante Henri Xhejms.

Mësimet e para, deri më 1855, i mori nga mësues privatë. Më pasi familja udhëtoi nëpër Evropë, arsimimi i tij vazhdoi në Londër, Paris dhe Gjenevë. Më 1862 u registrua për jurisrprudencë në Harvard. Si shkrimtar, fillimet e tij u ndikua nga Hawthorne dhe George Eliot. Pjesën më të madhe të rinisë e kaloi në Evropë, ku u "infektua" nga i ashtuquajturi "virus evropian". E deshi Evropën aq shumë, saqë për të qe e pamundur ku jetonte diku jetër, prandaj më 1898 u vendos përfundimisht në Londër, ku vdiq më 1916, një vit pasi qe bërë qytetar britanik.

Gjatë udhëtimeve evropiane, vizitoi shpesh Parisin, ku u shoqërua me shkrimtarë të tillë, si Turgeniev dhe Flober.

Është i njohur studimi i tij për Hawthorne, në të cilin ai thotë se Amerika nuk i ofron shumë material shkrimtarit: ajo s'ka histori të pasur, s'ka përmendore, institucione, vepra artistike, s'ka situata të ndërlikuara shoqërore dhe përvoja interesante. Për këtë arsye Xhejinsit i duheshin Evropa dhe evropianët, figura që paraqiten në funksion të historisë traditës së klasës dhe mjedisit të vet. Evropiani është më i ndërlikuar dhe "i prishur", përballë amerikanit të pastër dhe të virgjër, shpesh më të kufizuar, por moralisht më spontan. Amerikanit e Xhejmsit në kontakt me Evropën zhvillohen ose shkatërroben. Tema ndërkombëtare e lidhur drejtpërdrejt me shqetësimin e shkrimtarit, vetëdijen e njeriut, si dhe anët morale e psikologjike të përvojës së tij. Xhejmsin nuk e intrigon bota e jashtme, por mënyra sesi manifestohet ajo në vetëdijen e heronjve të tij. Ndonëse duket e përbërë nga një shumësi imtësish konkrete, të jashtme, bota e Xhejmsit para gjithash, një botë e brendshme e emocioneve dhe mendimeve, duke u bërë e afërt me botën e autorëve të mëdhenj modernë që do ta pasonin. Ndjenja e tij morale është një shqisë tepër e stërholluar për motivet sjelljes njerëzore, për raportet ndërmjet lirisë e dhunës, të mirës e së keqes. Ndërkaq, ai nuk mendon se romani duhet të ketë "një qëllim të vetëdijshëm moral". Për të, vlerat më të mëdha të veprës artistike varen nga vlerat shpirtërore dhe inteligjencës së shkrimtarit. Romani lind si rezultat i përshtypjeve të forta, të drejtpërdrejta, të cilat janë fryt "i sensibilitetit të thellë, i një farë rrjete merimange, fijet më të mira të së cilës, të shtrira në hapësirën e vetëdijes, janë të afta të mbajnë në sipërfaqen e vet edhe grimën më të vogël që ndeshin.

Realizmi i veçantë i përket atij psikologjik. Personazhet e tij më tepër e vëzhgojnë jetën, sesa e përjetojnë atë: ne jemi të interesuar të dime se si u përgjigjet mendja e tyre ngjarjeve të tregimit, se si ata përpiqen të kuptojnë ngjarjet.

Nëpërmjet veprave të tij të shumta, Henri Xhejms kërkoi të jetë një shkrimtar i ndjeshëm, me një kuptim të thellë për karakterin dhe motivimin njerëzor. Ai është më tepër një vëzhgues i mendjes, sesa rregjistër i kohës: theksi bie mbi proçesin që zhvillohet në vetëdijen e njeriut e jo mbi ngjarjen. Ngjarjet, shpesh, duken të parëndësishme, të kufizuara, por, në strukturën e veprës, shpesh marrin kuptim simbolik dhe shprehin gjendjen e gjithë qytetërimit.

Ia vlen të kujtojmë kuptimet e emrave të dy personazheve kryesore të librit që kemi në dorë: Deizi (Daisy) do të thotë "luledele", ndërsa Uinterborn (Winterbourne) "rrëke që vjen pas rrebesheve në dimër".

Stili i ndërlikuar dhe i shumëfishtë i prozës së tij duket dhe te Deizi Miler (Daisy Miller), njëra prej kryeveprave të tij të hershme.